

1 E mërkurë, 27 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
13 procesverbal vërej se të gjithë të akuzuarit janë në sallë
14 sot.

15 Përpara sesa të vazhdojmë me seancën dhe me dëshminë e
16 Dëshmitarit të Prokurorit 03873, ka disa çështje paraprake që
17 Trupi Gjykses dëshiroj t'i trajtojë.

18 Më 25 nëntor 2024, dokumenti 123452 deri në 123453 dhe
19 përkthimi përkues i tij janë pranuar dhe kanë marrë numrin e
20 provës P01861. Pas pranimit, Trupi Gjykses vërejti që
21 përkthimi në anglisht nuk përmban datën e raportit që u
22 pasqyrua, që ishte i pasqyruar në versionin anglisht dhe, për
23 rrjedhojë, Trupi Gjykses i kërkoi ZPS-së që të jepte një
24 version të rishikuar të përkthimit.

25 Në paketën e nxjerrjes së materialeve 1512, ZPS-ja ka

1 shtuar versionin e rishikuar të dokumentit 123452 deri në
2 123452-ET. Trupi Gjykses, për pasojë, e udhëzon GJDM-në që të
3 shtojë dokumentin 123452 deri në 123452-ET dhe që është
4 nxjerrë në paketën e nxjerrjes 1512 deri në P1861.

5 Kjo përfundon urdhrin gojor të Trupit Gjykses.

6 Po ashtu Mbrojtja e z. Veseli ka kërkuar që të bëjë disa
7 parashtrime.

8 Do ju kërkoja që parashtrimet t'i bënit për pesë minuta.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kërkojmë që
10 parashtrimet t'i bëjmë në fund të marrjes në pyetje të
11 dëshmitarit dhe përpara se të bëjnë pyetjet anëtarët e Trupit
12 Gjykses.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjini tani.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Me ç'kuptoq unë është një kërkim i
15 cili është një parashtrim të cilin do ta bëj në emër të të
16 gjitha ekipeve. E kuptoj që ekipet e tjera të Mbrojtjes duan
17 të shtojnë diçka dhe z. Pace kërkon që të kundërshtojë,
18 mendoj, e kundërshton faktin që unë do të bëj një kundërshtim.

19 Z. PACE: [Përkthim] Në të vërtetë është kështu, të
20 nderuar Gjykatës. Dje kur Mbrojtja na njoftoi pasdite lidhur
21 me synimin e vet që të bëjë kundërshtime, ne i kërkuam atyre,
22 që në paragrafin 7 të mund të jepeshin aspektet ligjore të
23 cilat ata do të donin që të parashtronin në kundërshtimet e
24 tyre.

25 Sot në mëngjes në orën 8.21 ne sapo u informuam nga

1 Mbrojtja që ata kanë thënë që dëshirojnë që të ngrenë disa
2 çështje ligjore që kanë të bëjnë me dokumentet e propozuara
3 për t'u përdorur nga Trupi Gjykses, më konkretisht, ato do të
4 kundërshtojnë aspektin ligjor, drejtësinë e përdorimit të
5 dokumenteve dhe sa të përshtatshme janë këto dokumente për t'u
6 përdorur, duke pretenduar cenim të tyre që ngrihet nga këto
7 dokumente dhe synon që të përdoren një numër të këtyre
8 dokumenteve dhe disa dokumenteve të tjera që janë nxjerrë
9 përpara sipas njoftimit të bërë në përputhje me qëndrimet
10 përkatëse.

11 Mbase kjo nuk është diçka të cilën ju e keni marrë.
12 Megjithatë, disa minuta më përpara, ne e kundërshtuam ngritjen
13 e këtyre çështjeve paraprakisht përpara pyetjeve të Trupit
14 Gjykses duke përfshirë gjithashtu edhe informacionin e ofruar
15 në parashtrimet të cilat janë thjesht një kopjim i F2718 dhe
16 që Trupi Gjykses ka është përgjigjur me shkrim më herët në
17 parashtrimin F2747 të datë 25 nëntor, në fakt.

18 Ne mendojmë që këto aspekte ligjore janë trajtuar dhe
19 kanë marrë përgjigje nga Trupi Gjykses.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Nuk do të kundërshtoj për momentin, megjithatë do t'i japë
22 Mbrojtjes pesë minuta për të dhënë parashtrimet e veta.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kanë të bëjnë -
24 - ajo çfarë duam të ngremë ne ka të bëjë me njoftimin lidhur
25 me dokumentet që do të përdoren. Janë dokumente të cilët bien

1 nën objektin e rregullës 102 dhe 103 që janë nxjerrë. Dhe ne i
2 kundërshtojmë përdorimin e këtyre dokumenteve.

3 Në kundërshtim me atë çfarë tha z. Pace, ne kemi të
4 drejtë si Mbrojtjes që të kundërshtojmë provat që
5 parashtrohen. Pra, së pari kemi dy pjesë të kundërshtimit
6 tonë. Së pari, kemi qindra faqe të cilat janë ngarkuar dje.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju korrigjoj pak, z.
8 Dixon, sepse nuk i keni marrë dje këto dokumente, i keni marrë
9 më përpara.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Po dje ka qenë hera e parë që ne
11 na është na është thënë që këto dokumente do të përdoren.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja ime është kjo, që
13 me sa kuptoj unë këto dokumente, ju, si Mbrojtje e Veselit,
14 keni vite që i keni në dispozicion apo jo?

15 Z. DIXON: [Përkthim] Unë kam ca kohë që i kam, por ekipet
16 e tjera nuk i kanë pasur. Të nderuar Gjykatës, ju e dini që ne
17 na duhet kohë sepse ky është një proces gjyqësor me palë
18 kundërshtuese. Dhe siç e dini, ne marrim gjithashtu edhe
19 shënimet përgatitore për dëshmitarët. Dhe ky nuk është njoftim
20 në kohë, nuk është i duhur. Është cenues për neve. Është i
21 padrejtë. Dhe kjo lidhet me thelbin që ne e kemi ngritur dhe
22 në mocionin tonë. Nuk është se do futem në më tepër hollësi.

23 Megjithatë unë po them që na duhet më shumë kohë në
24 mënyrë të tillë që të përgatitemi siç duhet sepse momenti kur
25 është identifikuar dokumenti për herë të parë ka qenë i vonë

1 në kohë.

2 Së dyti, sa i takon pranueshmërisë së dokumenteve dhe kjo
3 është një çështje që mbase do ta ngre pak më vonë. Ka disa
4 dokumente këtu që janë të papranueshme. Do të sjellë disa në
5 vëmendjen tuaj sa për ilustrim.

6 Si, për shembull, lidhur me deklaratën e Ferat Shalës.
7 Ferat Shala nuk është thërritur si dëshmitar në këtë çështje.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Dixon, deklarata e z.
9 Shala nuk është problem se këtë e ngritët dhe javën që shkoi
10 apo jo?

11 Z. DIXON: [Përkthim] Ne kundërshtojmë pranimin e dëshmisë
12 së tij sepse mund të pranohet vetëm në qoftë se thërritet
13 dëshmitari ose në qoftë se zbatohet një prej rregullave *lex*
14 *specialis*.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Asnjë nuk e ka ofruar për
16 pranim, z. Dixon.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull. Por mund të ndodhë që
18 t'ju kërkohet që të pranohet. Ndërkohë që kjo është pika e
19 parë.

20 Aspekti i dytë ka të bëjë me procesin gjyqësor të Drinit.
21 Dhe një herë këtu, të nderuar Gjykatës, flitet për datën 24
22 korrik 2023 dhe sa i takon vendeve që kanë të bëjnë -- dhe sa
23 i takon informacionit që kanë të bëjë përtej kohës së
24 aktakuzës, ato mund të çojnë në prova, por duhet që juve të
25 përcaktoni relevancën e tyre sepse është shumë e rëndësishme

1 që të përcaktohet kjo relevancë se kemi të bëjmë me ngjarje të
2 cilat janë përtej kohës së aktakuzës. Edhe një herë, në qoftë
3 se Prokuroria do ta bëjë këtë, duhet të na jepte njoftim
4 paraprak, në mënyrë të tillë që të kishim mundësinë e duhur që
5 t'i përgjigjeshim siç duhet kësaj.

6 Jemi në një situatë ku ne nuk e dimë se çfarë na pret.
7 Kemi kërkuar faqe konkrete që të identifikohen gjatë natës.
8 Kjo nuk na ka ndodhur akoma. Edhe ne nuk e dimë se çfarë
9 parashikon z. Pace dhe çfarë, sesi do të përgjigjet z. Pace
10 lidhur me këtë.

11 Ka dhe një problem tjetër që ka të bëjë me rastin e
12 Trupit Gjykues që nuk merr njoftim të duhur.

13 Dhe, së treti, kam diçka për të thënë lidhur me
14 pranueshmërinë, lidhur me dokumentet. Kemi të bëjmë me një
15 dokument të KFOR-it, i cili pretendohet që të vijë nga KFOR-i,
16 por është dokumenti 3. Dhe sërish ka të bëjë me pretendime për
17 një dëshmitar në vitin 2000, që përsëri koha këtu është përtej
18 kohës së aktakuzës që është përfshirë në një rrëmbim.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju bëj këtë pyetje,
20 z. Dixon. Sa i takon dokumentit 102(1)(3), a e kuptoj në
21 mënyrë të saktë që keni marrë njoftim sipas këtij rregulli nga
22 Prokuroria për dokumente që mund të përzgjidhen dhe që mund të
23 përmbajnë informacion që ata e konsiderojnë si relevant?

24 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a kam të drejtë unë që

1 e kam kuptuar që ju keni kërkuar nga secili, për secilin prej
2 këtyre dokumenteve nga Prokuroria që prezumohet që janë
3 relevante? A mund të prezumoj unë që ju i keni rishikuar këto
4 dokumente në kohën e duhur?

5 Z. DIXON: [Përkthim] Ne kemi kërkuar material shfaqësues
6 sepse ajo është e qartë --

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jo, jo, nuk po të pyes për
8 këtë. Po të pyes për dokumentet që bien nën rregullën 103. Po
9 ju pyes për 102(3). Këto janë dokumente që konkretisht
10 Prokuroria i përdor mbi supozimin që janë relevante dhe që
11 duhen të nxirren mbi këtë bazë për ju.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Ne kemi kërkuar një gamë të gjerë të
13 dokumenteve që janë përgatitur nga Mbrojtja, dhe ne i kemi
14 marrë të gjitha këto parasysh, përfshirë këtu edhe me këtë
15 dëshmitar. Por kur Prokuroria nuk njofton, nuk na njoftoi neve
16 që ata do të përdorin material të caktuar, ata na kanë thënë
17 që është material që nuk do të përdoret dhe pastaj
18 përqendrohemi në materiale të tjera.

19 Kjo është hera e parë që ne tani e dimë që ky material do
20 të përdoret me këtë dëshmitar dhe kërkojmë që të konsiderohet
21 nga Trupi Gjykues dhe të merret një vendim lidhur me këtë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do merret një
23 vendim më vonë.

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë, të nderuar
25 Gjykatës, ne kemi një çështje tjetër të ndryshme. Pra, sa i

1 takon Mbrojtjes së z. Thaçi, ne mund të themi që informacionin
2 që ka marrë Mbrojtja e z. Veseli dhe z. Selimi, pra, nuk është
3 se është informacion që ne kemi, dhe ndërkohë Mbrojtja mund të
4 kërkojë material që ka rëndësi materiale për përgatitjen e
5 vetë dhe, për këtë arsye, ne mendojmë që ky informacion duhet
6 të na vihet në dispozicion ne.

7 ZPS-ja nuk i ka përfshirë këto dokumente në listën e vet
8 të provave dhe këto dokumente nuk kanë qenë në listën e
9 materialeve të palëve, çfarë do të thotë që Mbrojtja e Thaçit
10 ka menduar që këto materiale nuk janë relevante për të.

11 Kështu që për herë të parë ne kemi marrë një material
12 prej një qind faqesh dje. Dhe ndërkohë është e pamjaftueshme
13 koha për neve për të kërkuar udhëzime nga klienti në Gjykatë.
14 Në qoftë se ne do të kishim ditur se cilat faqe ishin
15 relevante, do kishim marrë udhëzime më të drejtpërdrejta, por
16 ne nuk e kishim këtë informacion.

17 Dhe, përsëri, duke theksuar atë çfarë tha z. Dixon, në
18 qoftë se ZPS-ja vjen në Gjykatë edhe në mes të marrjes në
19 pyetje të një dëshmitari kërkon që të shtojë tre dokumente në
20 listën e tyre të materialeve që Mbrojtja nuk i ka marrë
21 asnjëherë, ne parashtrojmë, të nderuar Gjykatës, që kjo është
22 cenuese për ne dhe na mohon procesin e drejtë gjyqësor.

23 Pra, ky është kundërshtimi ynë. Pra, fakti që materialet
24 janë nxjerrë sipas rregullës 102(3), nuk do të thotë që ne
25 kemi një kopeje të tyre sepse neve na kërkohet që të

1 vlerësojmë dhe të përgatisim atë material që ka rëndësi
2 esenciale ose materiale për çështjen tonë. Kështu që për këtë
3 arsye do të luteshim që të konsideroni këtë gjë.

4 Z. PACE: [Përkthim] Më lejoni që të përgjigjem.

5 Së pari dua të them se parashtrimet e Mbrojtjes së z.
6 Veseli janë të parakohshme. Është e parakohshme që të kërkohet
7 për më tepër kohë. Sepse ne nuk kemi dëgjuar se cili prej
8 këtyre dokumente, në qoftë se do të përdoren, do të përdoren
9 nga Trupi Gjykses. Pra, në qoftë se do bëhet një kërkesë për
10 më shumë kohë duhet të bëhet më pas. Ne nuk po bëjmë
11 kundërshtim të dëshmimeve që të pranohen.

12 Por, sa i takon parashtrimin që është hera e parë që merr
13 qindra faqe, kjo është një çështje e cila është trajtuar. Nuk
14 është rasti ky që po merr qindra faqe për herë të parë, të
15 paktën nuk është rasti ky për Mbrojtjen e z. Veseli. Dhe në
16 këtë aspekt, dua të theksoj që thujse çdo dokument i njoftuar
17 nga Trupi Gjykses përmend dëshmitarin duke e përmendur atë
18 konkretisht me emër. 217 nga këto faqe janë deklaratë që
19 përmenden nga z. Ferat Shala. Ndërkohë që pjesa e shtatë e
20 kësaj deklarate i është vënë në dispozicion një dëshmitari të
21 Mbrojtjes së Krasniqit gjatë pyetjeve më datë 18 korrik, dhe
22 siç e tha dhe Gjykatësi Mettraux, Pjesa 1 dhe 2 të tyre në
23 veçanti, janë përmendur gjithashtu edhe në pyetje gjyqësore
24 javën e shkuar.

25 Përveç kësaj, dua që të sqaroj që ZPS-ja nuk ka asnjë

1 lloj detyrimi për të përfshirë të gjitha dokumentet që synon
2 të përdorë me një dëshmitar në seancën përgatitore. Edhe një
3 herë më lejoni të them, që ne nuk kemi asnjë detyrë, asnjë
4 detyrim që të japim specifikime për informacione ose
5 dokumentet që do të përdorim, por për aq kohë sa këto
6 dokumente janë në listën tonë të dokumenteve, kjo mjafton.

7 Përsëri, dua të them që parashtrimet janë të parakohshme
8 sa i takon edhe pranueshmërisë. Lidhur me deklaratën e Ferat
9 Shalës, të gjithë e dinë, Trupi Gjykses mbi të gjitha e di, që
10 pranueshmëria e një deklarate të mëparshme mund të përcaktohet
11 vetëm në qoftë se përmbushen kritere të caktuara të
12 rregullave.

13 Një tjetër gjë që dua të sqaroj nga Mbrojtja e z. Veseli
14 lidhur me parashtrimet e tij është që ZPS-ja nuk ka detyrim që
15 të ofrojë numrat e faqeve të dokumenteve në listën e
16 dokumenteve të tyre. Mesa më kujtohet mua, javët e shkuara ka
17 pasur raste kur një dëshmitar nuk i është përgjigjur pyetjeve
18 gjatë përgatitjes së dëshmitarëve. Dhe Mbrojtja ka njoftuar që
19 dy ose tre dokumente kanë qenë shumë të gjata në listën tonë
20 të prezantimeve të cilat ne mund t'i përdornim me dëshmitarin.
21 Në të njëjtën mënyrë, sa i takon kërkesës për Trupi Gjykses
22 për të treguar faqet, nuk ka bazë për këtë gjë as për ta
23 kërkuar.

24 Për aq kohë sa sipas rregullës 102(3) sipas kësaj
25 procedure, për aq kohë sa kemi kaq kohë që jemi në gjykim,

1 është e qartë për të gjithë se cila është procedura. Njoftimi
2 është aty. Palët mund ta bëjnë këtë në qoftë se dëshirojnë.
3 Palët janë plotësisht të vetëdijshme në përputhje me kuadrin e
4 nxjerrjes së materialeve të cilën unë e besoj që ka ekzistuar
5 tashmë që prej seancës paragjyqësore që Gjykatësit i marrin të
6 gjitha materialet në listë. Dhe është e qartë që e zgjidhin
7 palët që të kërkojnë konkretisht dokumente të tyre dhe pasojat
8 që mund të sjelli përdorimi i tyre.

9 Sa i takon nxjerrjes së materialeve dje, ne menjëherë i
10 jemi drejtuar Mbrojtjes për ta zgjidhur këtë çështje. Kemi
11 njoftuar Mbrojtjen e z. Thaçi sa i takon tre dokumenteve që
12 kanë përfunduar. Ato janë nxjerrë, besoj, brenda një ore dhe
13 po ashtu kemi një dokument dhe nga Mbrojtja e Selimit për të
14 cilin palët janë njoftuar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju, Mbrojtja
16 e Viktimave?

17 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

19 Z. DIXON: [Përkthim] E vlerësoj z. Pace që thotë që
20 subjekti i urdhrit tuaj, të nderuar Gjykatës, na ka dhënë ca
21 kohë në dispozicion sa i takon pyetjeve.

22 Por nga ana tjetër bëhet fjalë për deklaratën, sepse
23 deklarata do të regjistrohet në procesverbal. Dhe në këtë
24 rast, mendojmë që ky është kundërshtimi ynë. Domethënë, nuk
25 duhet që të përdoret kjo si provë kundër nesh.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Do bëj një vendim dhe do ju bëj me dije se cili është qëndrimi
3 ynë.

4 Z. Ellis.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Qëndrimi ynë ka të bëjë me
6 materialin 102(3).

7 Atëherë është me vlerë që të kujtojmë që lista origjinale
8 përmban 68.000 dokumente. Kemi kërkuar dokumente prej tyre.
9 Janë dokumente të cilët janë përdorur si bazë për hetimet e
10 Mbrojtjes. Megjithatë tani kemi dokumente shumë më tepër sesa
11 68.000 dokumente, 68.000 faqesh të cilat përdoren me një
12 dokument konkret edhe këtu qëndron problemi sipas nesh.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

14 Z. TULLY: [Përkthim] Mbështes plotësisht atë çfarë u
15 ngrit nga kolegët e mi, në veçanti nga znj. Tavokoli.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Siç e thashë do marrim një vendim lidhur me këtë.

18 Do të vazhdojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të
19 Prokurorisë 03873.

20 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

21 Z. Ellis.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam rishikuar
23 qëndrimin tonë gjatë natës dhe dua t'ju them që nuk kam pyetje
24 për këtë dëshmitar.

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam pyetje

1 plotësuese, jo shumë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
4 procesverbal vërej që Avokati Kujdestar për Dëshmitarin 03873
5 është i pranishëm në sallën e gjyqit.

6 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

7 Mirëmëngjes, Avokat.

8 Dëshmitar, sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju
9 kujtoj që duhet t'i përgjigjeni pyetjeve me fjali të shkurtra
10 dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht
11 mund ta pyesni avokatin përkatës që nuk e kuptuat pyetjen ose
12 që ta përsërisë dhe një herë pyetjen. Po ashtu, ju lutem
13 kujtoni që të thoni që cila është baza e njohurive fakteve dhe
14 rrethanave për të cilat do të pyeteni.

15 Ju kujtoj që jeni përsëri nën betimin që -- nën detyrimin
16 që të thoni të vërtetën ashtu siç keni thënë në betimin
17 solemn. Ju kujtoj gjithashtu që garancitë të cilat ju janë
18 dhënë nga Trupi Gjykses janë ende të zbatueshme dhe refuzimi
19 për të dhënë dëshmi mund të sanksionohet me një gjobë.

20 Ju lutem flisni pranë mikrofonit, prisni pesë sekonda
21 përpara se t'i jepni përgjigje një pyetjeje dhe flisni me
22 ritëm të ngadaltë për hir të përkthyesve.

23 Nëse e shihni të nevojshme për të bërë një pushim, na e
24 bëni me dije këtë gjë dhe ne do të bëjmë organizimet
25 përkatëse.

1 Nuk kanë më pyetje ekipet e Mbrojtjes. Ndërkohë që
2 Prokuroria ka kërkuar leje për të bërë disa pyetje plotësuese
3 për ju. Për këtë arsye do t'i jap fjalën z. Pace.

4 Z. Pace, fjala është për ju.

5 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

6 DËSHMITARI: HALIL QADRAKU

7 Pyetje vijuese nga z. Pace:

8 Z. PACE: [Përkthim

9 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

10 PË. Mirëmëngjesi.

11 PY. Së pari do të lexoj disa pyetje dhe përgjigje nga pyetjet
12 që ju bënë dje nga Ekipet e Mbrojtjes.

13 Z. PACE: [Përkthim] Për ata që dëshirojnë të na ndjekin
14 këto janë marrë nga transkripti në kohë reale i ditës së
15 djeshme, do të lexoj nga faqja 94, rreshti 15, në faqen 95,
16 rreshti 10.

17 PY. Dëshmitar, kjo nuk do të jetë në ekranin tuaj, kështu që
18 dua që të dëgjoni përkthimin.

19 "PY. Dhe kjo e drejtë, apo jo, që z. Ferat Shala dhe z.
20 Ilmi Reçica kanë qenë homologët tuaj? Ata kanë qenë shefat e
21 G2 në Drenicë dhe Nerodimë, përkatësisht, duke i raportuar
22 shefave dhe komandantëve të zonave të tyre.

23 "PË. Unë besoj që këto kanë pas këto pozita në zonat e
24 tyre. Unë nuk e kam njoftur as Ferat Shalën, as Ilmi Reçicën
25 gjatë luftës. I kam njohur pas luftës.

1 "PY. Ju keni pas asnjë lloj ndërveprimi ose asnjë lloj
2 bisede me ta gjatë luftës, apo jo?

3 "PË. Sapo e thashë që nuk i kam njohur ata. Mund të ketë
4 ndodhur që t'i kem takuar, por nuk e kam ditur që kanë qenë
5 ata.

6 "PY. Mesa dini ju ata nuk punonin si zëvendës të z.
7 Veseli, apo jo? A është e saktë kjo?

8 "PË. Mesa di unë, po. Nuk e di në qoftë se ata kanë
9 punuar si të tillë apo jo. Nuk i kam njohur fare këta persona.

10 "PY. Pra, për të qenë të qartë ju nuk e keni ditur se
11 çfarë pune bënë ata përveç faktit që ata kanë punuar në G2 e
12 zonave që unë i përmenda pak më herët në Nerodimë dhe në
13 Drenicë, a është e saktë kjo?

14 "PË. Saktë. Po përsëri, dua të them që nuk i kam -- nuk
15 i njihja ata personalisht dhe mund ta kem pasur gabim këtu.
16 Thjesht e di që ata ishin në zonat e tyre, pra, njëri ishte,
17 punonte për zonën e Nerodimës dhe tjetri nga Drenica."

18 Tani dua që të shfaq një fragment, një paragraf nga
19 intervista që keni pasur me ZPS-në. Do t'ju lexoj dhe këtë,
20 Dëshmitar dhe pastaj do t'ju bëj një pyetje.

21 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoj që të paraqitet në ekran
22 prova P01854.5-ET përbri versionit në shqip 01854.5-AT. Në
23 anglisht do lexoj nga faqja 9, rreshtat 3 deri në 8 që përkon
24 me versionin në shqip të faqes 7, rreshtat 22 deri në faqen 8,
25 në rreshtin 2.

1 Në versionin në shqip, ju lutem kalojeni pak më poshtë në
2 faqe. Atëherë do fillojmë në rreshtin 22, pastaj do vazhdojmë
3 me faqen 8.

4 PY. Edhe një herë për sqarim, Dëshmitar, në ekran keni në të
5 majtë një version të deklaratës që i keni dhënë në 2019 ZPS-
6 së, pra, që është intervista me ZPS-në në 2019, që është
7 pranuar në provë gjyqësore.

8 "PY. Sa kujtoni ju kush ka qenë zëvendësi i tij?

9 Përgjigja që ju jepni është:

10 "Ferat Shala dhe Ilmi Reçica. Unë nuk e di në qoftë se
11 ata kanë qenë zëvendës ose pjesë e stafit të tij, por unë e di
12 që jam takuar me ta në Shtabin e Përgjithshëm"

13 Dëshmitar, për të qenë të qartë, kur jeni pyetur se "kush
14 kanë qenë zëvendësit e tij", bëhej fjalë këtu për Kadri
15 Veselin.

16 Siç mund ta shikojmë këtu në intervistën e ZPS-së ju keni
17 thënë që e keni kuptuar që Ferat Shala dhe Ilmi Reçica kanë
18 qenë zëvendësit e z. Veseli ose anëtarë të stafit ose
19 personelit të vet. Ndërkohë që gjatë pyetjeve të ekipit të
20 Mbrojtjes ju thoni që besoni që ata kanë qenë shefat e G2 në
21 Drenicë dhe Nerodimë dhe keni deklaruar po ashtu që nuk e
22 dinit se çfarë pune bënin ata.

23 Pyetja ime për ju është kjo: Ndërkohë që ju nuk e dini
24 konkretisht ose në mënyrë precize të saktë se çfarë pune bënin
25 ata, ju e keni kuptuar që ata punonin për z. Veseli si

1 zëvendës ose si anëtarë të personelit të z. Veseli?

2 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është një
3 keqinterpretim i asaj çfarë ka thënë dëshmitari përpara jush,
4 të nderuar Gjykatës. Asnjëherë nuk ka thënë dëshmitari që këta
5 dy persona kanë qenë zëvendësit e tij ose pjesë e personelit
6 të tij. Ai thotë unë nuk e di. Nuk duhet të lejohet një lloj
7 pyetjeje e tillë sepse nuk ka thënë kështu dëshmitari.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë po lexoja
9 ekzaktësisht atë çfarë ka thënë Avokati dje dhe pjesën e
10 deklaratës që ka dhënë vetë dëshmitari për ZPS-në.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
12 kundërshtimi.

13 Z. PACE: [Përkthim]
14 PY. Do e përsëris e dhe një herë pyetjen për ju, Dëshmitar.
15 Në intervistën që i keni dhënë ZPS-së, ne sapo e pamë, që ju
16 keni thënë që Ferat Shala dhe Ilmi Reçica ose kanë qenë
17 zëvendës të z. Veseli ose kanë qenë pjesë e personelit ose
18 stafit që punonin për të.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Kundërshtojmë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
21 u rrëzua. Dhe do të vazhdojë të bëj të njëjtën gjë. Sepse siç
22 e dini ne kemi një procedurë të disponueshme që ju duhet të
23 ndiqni, domethënë, megjithatë kjo procedurë kërkon që ju të
24 mos flisni përpara dëshmitarit.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, thjesht po them

1 që është keqinterpretim.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E thashë edhe
3 një herë që kundërshtohet kundërshtimi juaj, kështu që mos
4 ndërprisni më.

5 Z. PACE: [Përkthim]

6 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, në intervistën që i keni dhënë
7 ZPS-së ju keni thënë që e keni kuptuar që Ferat Shala dhe Ilmi
8 Reçica ishin ose zëvendës të z. Veseli ose anëtarë të
9 personelit të vet. Por gjatë pyetjeve të avokatit ju keni
10 thënë që besonit që ata kanë qenë shefa të G2 në Drenicë dhe
11 në Nerodimë, por keni deklaruar që nuk e dinit se çfarë pozite
12 ose çfarë pune kishin ata konkretisht.

13 Pyetja ime për ju është kjo: Ndërkohë që ju nuk e dinit
14 në mënyrë të saktë se çfarë pune bënë ata, ju e kishit
15 kuptuar që ata punonin për z. Veseli ose si zëvendësit e vet
16 ose si anëtarë të stafit ose të personelit të z. Veseli?

17 PË. Unë mendoj se këtë deklaratë e kam dhënë në vitin 2019
18 pranë Prokurorisë të Zyrës Speciale, 20 vite pas luftës, 20
19 vite pas luftës. Edhe njohuritë e mia me Ilmi Reçicën edhe
20 Ferat Shalën, unë tani i njoh, mirëpo nuk më kujtohet
21 konkretisht se kur i kam njohur, kur i kam parë ata të dy.

22 Mund të kem thënë që mendoj, sepse ata pas luftës, ata
23 pas luftës kanë punuar si bashkëpunëtorë, mendoj, të Kadri
24 Veselit. Ashtu edhe kam dëgjuar. E ndoshta në këtë kontekst
25 unë e kam thënë në vitin 2019 se mendoj se ata kanë

1 bashkëpunuar apo kanë qenë pjesë e stafit të Kadri Veselit,
2 por gjatë luftës unë ju kam thënë dhe prapë e them se nuk jam
3 takuar me ta në bazë të sektorit. Nuk kam bashkëpunuar me ta
4 në bazë të sektorit edhe nuk i kam dhënë raport apo nuk më
5 kanë dhënë ndonjë urdhër ata mua në sektorin tim.

6 PY. Dëshmitar, a po thoni -- më falni.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Po, z.
8 Avokat.

9 Z. KOCI: Gjykatë e nderuar, unë jam shumë i kujdesshëm që
10 me ndërhyrje të mia mos me ndiku në asnjë mënyrë në
11 dëshmitarin. Po meqenëse po hyjmë me një pjesë të pyetjeve
12 komplekse, ndoshta është mirë kur del pyetja në gjuhën angleze
13 me qenë edhe në shqip. Për shkak se klienti im nuk din
14 anglisht.

15 Unë e kam këtu versionin në anglisht po nuk e kam edhe në
16 shqip të pyetjes. Faleminderit. Kërkoj falje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni
18 shqipen?

19 Z. PACE: [Përkthim] Po.

20 PY. Do kthehemi pak mbrapa për t'ua lexuar atë që ju është
21 pyetur gjatë intervistës me ZPS-në.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 [Përkthim] A mund ta nxirrni në ekran në shqip, ju lutem?

24 Z. PACE: [Përkthim] Pikësëpari, ishte në shqip në ekran
25 ajo që lexova unë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë po
2 verifikoja.

3 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Të lutem të më
4 ndihmojnë edhe kolegët që flasin shqip. Në anglisht do lexoj
5 nga faqja 8, rreshti 10 i të njëjtit dokument. Në shqip,
6 shpresoj që ta kem të saktë, më duket se është e njëjta faqe
7 po fillon në rreshtin 5. Po do i lutesha një përkthyesi nga
8 gjuha shqipe që faqja 8, rreshti 5 i korrespondon faqes 7,
9 rreshtit 5 në shqip.

10 Faleminderit. Avokat, e keni në ekran besoj tani.

11 PY. Dëshmitar, po ju lexoj të njëjtën intervistë, po disa
12 rreshta para pyetjes dhe përgjigjes që ju bëra. Do ua lexoj
13 dhe pastaj do t'ju bëj pyetje:

14 "PY. Sepse këtë po përpiqem të kuptoj, sepse kuptoj që
15 z. Veseli ka pas përgjegjësi për të gjithë Kosovën, territorin
16 e Kosovës. Kështu që ju në të gjithë Kosovën mund të keni
17 probleme të ngjashme, një Llap, një në Pashtrik dhe unë besoj
18 se ai kalonte mesazhet prej komandës së zonës. Po, nuk e dinit
19 ju ... nëse nuk do informoheshit nga niveli i lartë?

20 "PË. Unë ... gjithë puna ime që kam bërë unë ka qenë
21 vetëm me informu Shtabin e Përgjithshëm. Edhe unë veç këtë
22 punë kam bë, asgjë më shumë. Unë nuk kam ardh kurrë, nuk mbaj
23 mend as nuk di që ndonjëherë ai ka kërkua nga unë sepse ne e
24 kemi lënë hapësirë për të kërkuar diçka nga ne. Edhe kohën më
25 të madhe të kësaj periudhe që unë po flas, ai nuk ka qenë në

1 Kosovë". Të kalojmë tek faqja tjetër në anglisht. "Nuk ka qenë
2 në Kosovë pjesën më të madhe të kohës. Ishte gjithmonë ose në
3 Rambuje ose në Oslo për të nënshkru marrëveshje. Ka qenë
4 jashtë shumicën e kohës.

5 "PY. Mesa kuptoni ju, kush ka qenë zëvendësi i tij?

6 "PË. Ferat Shala dhe Ilmi Reçica. Unë nuk e di a ishin
7 zëvendës apo anëtarë të shtabit, por i di që i kam takuar në
8 Shtabin e Përgjithshëm."

9 Siç e shihni, Dëshmitar, ju jeni përgjegjgur të paktën për
10 një periudhë kohore që i përket periudhës kohore të Rambujesë
11 që i takon marsi 1999. Sot paradite, ju po i thonit Trupit
12 Gjykues që përgjigjen lidhur me pozicionin e Shalës dhe të
13 Reçicës mund ta keni për periudhën pas luftës pra.

14 A mund të na shpjegoni pse ka një mospërputhje mes
15 deklaratës së mëparshme që i keni dhënë Prokurorisë këtu në
16 2019 dhe dëshmisë që keni dhënë gjatë kundërpjetjeve nga
17 Mbrojtja por edhe sot paradite për Trupin Gjykues?

18 PË. Unë mendoj se jam tu e tregu të vërtetën. Nuk mendoj që
19 këtu kam folur për marsin dhe prillin e 1999. Unë në prill, më
20 1 prill të vitit 1999 kam takuar Kadri Veselin dhe më nuk kam
21 takuar asnjë zëvendës, asnjë punëtor të shërbimit tonë në
22 Shtab të Përgjithshëm. Unë vetëm ju tregova se kur më kanë
23 pyetur në Prishtinë kush ka mundur të zëvendësoj. Domethënë,
24 ishte 20 vjet njohje tani me ata edhe mund ta kem thënë në
25 këtë kuptim, duke menduar unë, se ata mbas luftës kanë qenë

1 zëvendës të Kadri Veselit apo bashkëpunëtorë të zyrës së tij.
2 Por që të kem dëshmuar se ata kanë qenë zëvendës, nuk e kam
3 pas këtë njohuri.

4 Ka mund vetëm ta them në atë, në bazë të asaj çfarë unë e
5 kujtoj gjatë 20 viteve të fundit. Por të kem përmendur datë që
6 nga marsi deri në prill të 1999 të jenë ata zëvendësit e tij,
7 unë nuk e besoj që e kam përmend datën. Mund të jem edhe
8 ngatërruar. Janë vite të kaluara këto. Kaq kam ditur të ju
9 tregoj, kaq di sot t'ju tregoj.

10 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të më tutjeshme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse më lejoni kam një çështje
13 përkthimi mbasi para se të vijojmë më tej kam diçka.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Në qoftë
15 se është çështje përkthimi.

16 Z. DIXON: [Përkthim] Po mund ta bëjmë këtë pa praninë e
17 dëshmitarit për të qenë të kujdesshëm.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
19 bëjmë një pushim të shkurtër tani. Përpara se të bëjmë dhe ne
20 Gjykatësit pyetjet tona, do ta bënim një pushim sidoqoftë.

21 Mund të largoheni tani nga salla e gjyqit. Ju lutem mos
22 diskutoni me askënd për dëshminë tuaj.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Nuk doja të ndërprisja
25 kur po fliste Prokurori, po mesa kuptojmë ne ka një problem

1 përkthimi me shkrim tek përgjigja që ka dhënë ai lidhur me z.
2 Shala dhe Reçica, e kemi fjalën për përkthimin e Prokurorisë
3 me shkrim jo për përkthyesit e Gjykatës. Ju lutem bëni një
4 verifikim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na jepni
6 faqen dhe rreshtin përkatës.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Në anglisht bëhet fjalë për
8 rreshtin 6 edhe 7. Unë nuk flas shqip, po ma thotë ekipi im
9 këtë gjë - po këtu ku thuhet që në shqip fjala "personeli i
10 tij" nuk është në shqip. Ai nuk ka thënë gjë që:

11 "Kanë qenë pjesë e personelit të tij, të shtabit të tij"

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë kërkoni
13 që të verifikohet?

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po, ju lutem verifikojeni. Mund të
15 mos jetë dhe asgjë, po për të qenë ne të sigurtë, ju lutem
16 bëni një verifikim. Më është kërkuar që të verifikohet kjo.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëhet fjalë
18 për një deklaratë të mëparshme jo për transkriptin? Ndiqni
19 hapat përkatës, kërkojini Zyrës Administrative që të bëjë
20 verifikimin e intervistës.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Unë e thashë për procesverbal për të
22 qenë të sigurtë. Nëse s'ka asgjë, atëherë nuk ka problem.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
24 thërrisni më dëshmitarin?

25 Z. PACE: [Përkthim] Mund të bëhet verifikimi. Por edhe

1 sikur të ketë vërtetë ndonjë gabim, unë nuk kam asgjë për të
2 diskutuar më tej lidhur me këtë dëshmitar.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit për këtë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 [Përkthim] Në rregull. Do të bëjmë gjysmë ore pushim tani
6 në mënyrë që të trajtojmë mocionin tuaj, pyetjet tuaja dhe do
7 të kthehemi në orën 10.10.

8 Në rregull. Bëjmë pushim deri në orën 10.10.

9 --- Seanca ndërpritet në orën 09.40

10 --- Seanca rifillon në orën 10.36

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
12 vazhdojmë me pyetjet e Trupit Gjykses për Dëshmitarin e
13 Prokurorisë W03873 Trupi Gjykses do të trajtojë dy aspekte.

14 Së pari, sa i takon parashtrimeve të paradites duam të
15 sqarojmë sepse nuk ka ngarkuar materiale, po ka dërguar
16 njoftim përmes postës elektronike për materialet që do të
17 përdorë Trupi Gjykses me këtë dëshmitar.

18 Së dyti, Trupi Gjykses vëren se për t'ju dhënë palëve dhe
19 pjesëmarrësve njoftim paraprak për materialet e rregullës
20 102(3) dhe materialet e rregullës 103 Trupi Gjykses i merr
21 gjithmonë parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me këto materiale.
22 Dhe këtë po e themi se njoftimi bëhet në përputhje me urdhrin
23 me gojë të Trupit Gjykses të datës 5 qershor 2024.

24 Pasi morëm parashtrimet e palëve lidhur me dokumentet që
25 njoftohen para se të fillojnë pyetjet e Trupit Gjykses, kemi

1 vendosur që të mos marri vendim për momentin, po do të marrim
2 parasysh gjithmonë parashtrimet që u dhanë sot paradite kur të
3 japim vendim lidhur me parashtrimin e protokolluar 51728 dhe
4 parashtrimet e tjera të protokolluara.

5 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses do të vazhdojë me pyetjet
6 dhe nëse Mbrojtja ka nevojë për kohë përpara se të bëjë
7 pyetjet që burojnë nga pyetjet e Trupit Gjykses atëherë le të
8 na njoftojë ne paraprakisht sa kohë ju nevojiten që të
9 përgatiten.

10 Dhe me kaq mbyll urdhrin me gojë.

11 Së dyti.

12 Më 26 nëntor 2024, Trupi Gjykses i dha një numër të
13 provës provizore materialit 113623-02 dhe numri provozor që i
14 dha ishte P01863.

15 ZPS-ja i tregoi disa pjesë të materialit 113623-02
16 Dëshmitarit W03873, por kërkoi që të pranohej në tërësinë e
17 vet materiali me numër 113623-02. ZPS-ja arugmenonte se
18 tërësia e këtij materiali përfshirë edhe fragmentet që nuk i
19 ishin treguar dëshmitarit ishin relevante për çështjen e tyre,
20 ndihmoni për të plotësuar kontekstin.

21 Ekipi i Mbrojtjes së Veselit e kundërshtoi pranimin e
22 videos së plotë dhe argumentoi se duhej të pranoheshin vetëm
23 ato pjesë së videos që i ishin treguar dëshmitarit.

24 Pasi dëgjuam parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses është
25 bindur se pranimi i plotë i videos me numër 113623 është

1 relevant dhe ndihmon për t'u kuptuar më mirë konteksti. Edhe
2 ndihmon gjithashtu për të kuptuar prejardhjen e kësaj video
3 dhe ka tregues të relevancës.

4 Sa i takon vlerës provuese së këtij materiali, Trupi
5 Gjykues vëren se dëshmitari konfirmoi se ajo që ç'ka ka thënë
6 në këtë video është e vërtetë, përfshirë pjesët që iu treguan
7 dëshmitarit, por edhe pjesët që përdori Mbrojtja. Dhe
8 dëshmitari konfirmoi përmbajtjen e fragmenteve që pamë.

9 Së fundi, Trupi Gjykues vëren se kjo nuk ka asnjë efekt
10 cenues. Mbrojtja ka pasur mundësi ta përdori materialin që
11 mori numrin e provës provizore 01863 në kundërpjetjet e veta.

12 Përpara se të fillojmë. Nëse keni ndonjë gjë që do ta
13 trajtoni kur të kemi ne pyetjet tona, ju lutem bëjeni pa
14 praninë e dëshmitarit. Bëni një sinjal që doni të thoni diçka,
15 dhe do t'i kërkojmë dëshmitarit të dalë nga salla, në mënyrë
16 që ju të flisni lirisht.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Sa i takon urdhrin të
18 dytë me gojë, duam të konfirmojmë që prova materiale e cila
19 kishte numrin provizor P01863, tashmë merr numrin
20 përfundimtar, por që është i njëjti P01863.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Më falni, se e kisha fikur mikrofonin. Do bëjmë një
24 seancë tani, pastaj do bëjmë gjysmë ore pushim dhe do
25 përpiqemi që të përfundojmë përpara pushimit të drekës.

1 Sidoqoftë të shohim si do të shkojë seanca.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
4 kërkojmë falje për këtë shkëputje kaq të gjatë, por ndonjëherë
5 është e nevojshme të trajtojmë disa aspekte pa praninë tuaj.
6 Do të vazhdojmë. Tani e kanë radhën Gjykatësit. Gjykatësit
7 kanë pyetje për ju.

8 I pari do të jetë Gjykatësi Barthe, që është në të majtën
9 time. Dëgjojeni me vë mendje.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
11 Smith.

12 Pyetje nga Trupi Gjykses:

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe mirëdita z. Qadraku dhe
14 z. Koci.

15 Z. Qadraku, edhe Trupi Gjykses ka pyetje për ju që
16 besojmë që janë të nevojshme për të kuptuar më mirë dëshminë
17 tuaj, po edhe për të sqaruar disa nga aspektet që janë
18 trajtuar prej palëve.

19 Pyetja ime e parë është lidhur me atë që i thatë
20 Prokurorisë gjatë seancës përgatitore javën e kaluar dhe është
21 pasqyruar në Shënimin Përgatitor numër 1. Sipas paragrafit të
22 atij shënimi, i keni thënë Prokurorisë se jeni arrestuar dhe
23 më pas jeni dënuar me 18 muaj burgim, për shkak se keni
24 përshëndetur me grusht presidentin Enver Hoxha, në atë kohë që
25 vdiq, më 11 prill 1985. Për këtë akuzë jeni dënuar pra.

1 Unë desha t'ju pyesja, a e keni ngritur vërtetë grushtin
2 apo jo ju, për të nderuar presidentin shqiptar Enver Hoxha?
3 Pra, e ngritët vërtetë grushtin apo jo?

4 PË. Zotëri Gjykatës, edhe atëherë Prokurorëve, hetuesve të
5 Ushtrisë Jugosllave ju kam thënë se ajo nuk është e vërtetë,
6 sepse unë nuk do ta ofendoja presidentin e Shqipërisë së
7 atëhershme, zotninë Enver Hoxha para flamurit jugosllav që ta
8 përshëndes. Shqipëria dhe Enver Hoxha kishin flamurin
9 shqiptar. Ishim në ngritje të flamurit jugosllav neve atëherë.
10 Kështu që nuk do ta bëja kurrë atë ofendim, as nuk e kam bërë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, me fjalë
12 të tjera, akuza ka qenë e padrejtë? Kështu? Ju vërtetë nuk
13 keni përshëndetur me grush?

14 PË. Është shumë e vërtetë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këtë doja ta sqaroja.
16 Faleminderit.

17 Pyetja e radhës apo pyetjet e radhës më saktë lidhen me
18 paragrafin 13 të Shënimit Përgatitor numër 1. Më konkretisht
19 çfarë keni thënë në faqen 6 të këtij shënimi.

20 Ju keni thënë, sipas kësaj që shohim ne këtu, sipas asaj
21 që ka pasqyruar Prokuroria, keni thënë që kur keni hyrë në
22 Kosovë nga Shqipëria me një grup prej rreth 18 personash, në
23 janar 1999, keni qenë një ndër grupet e para që keni hyrë pas
24 komandant Drinit, Ekrem Rexhës, Mujë Krasniqit, edhe ju thatë
25 që ka qenë dhe një rast kur studentët nga Krusha e Madhe iu bë

1 pritë. A ju kujtohet që ja keni thënë këtë Prokurorisë gjatë
2 seancë përgatitore?

3 PË. Po, zotëri.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini ju se ka pasur
5 pretendime që komandant Drini ka qenë përgjegjës për pritën
6 dhe vdekjen e Mujë Krasniqit?

7 PË. Zotëri Gjykatës, në atë kohë unë kam qenë atje. Unë e kam
8 përcjellë edhe komandant Drinin, i kam dhënë lamtumirën, në
9 fakt, komandant Drinit, Mujë Krasniqit edhe atyne 140 shokëve
10 që janë nisur në 14 dhjetor. Pas rënies të këtyne në pritë,
11 normalisht që të gjithë, edhe Xheladin Gashi, Plaku, edhe ata
12 shokë që ishin aty në Cahan që mund ta veçoj ato, Krasniqin
13 mund ta veçoj, Ramadan Selimin, vëllaun e z. Rexhep Selimi.
14 Mund t'i veçoj të gjithë ata shokët tanë, se të gjithë kemi
15 bërë përpjekje që ta kuptojmë se çfarë ndodhi në atë pritën e
16 14 dhjetorit kur na u vranë mbi 46 ushtarë.

17 Kurrë, kurrë nuk -- kurrë nuk mbaj mend që ta kemi
18 fajësuar dikënd, dikënd me emër e mbiemër për atë shkak sepse
19 e dinim se ishte një rënie në pritë. Ishte një luftim i
20 pabarabartë në pozicione e armatim. Kështu që nga ana e ime,
21 sa kam unë njohuri. Duke qëndruar ato ditë në Cahan, nuk ka
22 bisedu dikush që ta fajësojë komandant Drinin për atë ngjarje,
23 sepse dhe vetë ai ishte pjesë e atij grupit të madh.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk keni dëgjuar
25 vetë të ketë pasur ndonjë pretendim kundër komandant Drinit që

1 ai medemek ka qenë përgjegjës për pritën ose për vdekjen e
2 Mujë Krasniqit konkretisht. Këtë po thoni, që nuk keni dëgjuar
3 diçka të tillë?
4 PË. Zotëri Gjykatës, sot 25 vite pas luftës memoria ime,
5 kujtesa ime ka shumë lloj informacionesh. Unë fola në emër të
6 atij stafit të UÇK-së që atëherë ishim në Cahan. Pas luftës,
7 shumë shkrime, shumë gazeta, shumë njerëz që ishin të
8 orientuar politikisht kundër nesh kishin dhënë lloj-lloj
9 konspiracionesh në këto drejtime edhe është përfolur shumëçka
10 saqë sot nuk do të -- nuk do të mundja t'i përmbledhja të
11 gjitha akuza që kanë ndodhur nga kundërshtarët tanë politikë
12 për të njollosur një njeri apo një njeri tjetër. Janë të
13 gjitha insinuata, janë të gjitha shpifje. Janë të gjitha
14 prodhim keqdashës.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mujë Krasniqi
16 kishte lidhje me ndonjë të akuzuarit që janë në këtë sallë
17 gjyqi? Keni ndonjë dijeni për këtë?

18 PË. Shumë më vonë unë kam mësuar që ka pas lidhje familjare
19 me Rexhepin edhe me Ramadan Selimin, si dajë e nip apo si nip
20 e dajë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jemi të qartë, thatë
22 Rexhep dhe Ramadan Selimi. E keni fjalën që Mujë Krasniqi
23 kishte lidhje familjare me ta? Pra, unë ju pyeta, Mujë
24 Krasniqi a ka pasur ndonjë lidhje me ndonjë nga të akuzuarit
25 që janë këtu në sallën e gjyqit?

1 PË. Unë nuk e di, unë nuk e di saktësisht. Kam lexuar që ka
2 pas lidhje familje me Rexhep Selimin edhe Ramadan Selimin, që
3 është vëllau i Rexhep Selimi. Domethënë e gjitha kjo është nga
4 leximet që kemi lexuar nëpër gazeta apo se si kanë filluar.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra ju nuk keni informacion
6 nëse Mujë Krasniqi ka pas lidhje me ndonjë nga të akuzuar. E
7 lemë mënjane z. Ramadan Selimi, se nuk po flasim për et
8 njëjtin person. Pra, ju nuk keni dijeni a ka pasur lidhje me
9 ndonjë nga të akuzuarit Mujë Krasniqin. E lemë Ramadan Selimin
10 mënjane.

11 PË. Nuk kam pas dijeni timen, s'kam pas.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Shohim
13 paragrafin 16 të Shënimit Përgatitor numër 1. Këtu keni
14 përmendur Shtabin e Përgjithshëm në Kleçkë. Dhe sipas këtij
15 shënimi keni thënë që ka të ngjarë të ketë shkuar tek radio
16 Kosova e Lirë dhe tek Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në
17 Kleçkë. Nuk ka qenë nevoja të shkonit atje herë të tjera,
18 sepse nëse kishte informata për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-
19 së, ky informacion i çohet komandantit të Zonës Operative të
20 Pashtrikut, dhe çdo informacion që mund të kishit ju për
21 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, do të dërgohej përmes
22 komandantit të Zonës Operative të Pashtrikut.

23 Tani unë kam këtë pyetje, z. Qadraku: Shtabi i
24 Përgjithshëm apo më saktë selia e Shtabit të Përgjithshëm ka
25 qenë në Kleçkë apo ka qenë në Divjakë? Selia e Shtabit të

1 Përgjithshëm, në Kleçkë apo në Divjakë në atë kohë?

2 PË. Unë e mbaj mend se selia e Shtabit të Përgjithshëm ka
3 qenë në Kleçkë. Nuk e di ku është dallimi mes Kleçkës dhe
4 Divjakës edhe Berishës, se nuk i njoh ato fshatra mirë. Kam
5 qenë dy, tri herë. Nuk i njoh kufijtë e fshatrave ku mbaron
6 Kleçka, ku fillon Divjaka.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto dy fshatra, Kleçka dhe
8 Divjaka, janë afër njëri-tjetrit. Keni ndonjë dijeni?

9 PË. Unë e vesoj se janë afër. Nuk e di cila është cila.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Për një temë
11 tjetër, por në të njëjtin paragraf keni thënë dhe e keni
12 përsëritur edhe dje më duket gjatë pyetjeve që ju bënë palët.
13 Keni thënë që ju personalisht nuk e keni kontaktuar asnjë
14 drejtpërsëdrejti Shtabin e Përgjithshëm. Me përjashtim të
15 letrës që pamë ne, që kishte datën 14 mars 1999, për të cilën
16 thatë që nuk ishit i sigurt a kishte shkuar ndonjëherë kjo
17 letër në Shtabin e Përgjithshëm. Sidoqoftë, pyetja ime është
18 kjo: Është ende dëshmia juaj që -- pra, i qëndroni dëshmisë
19 tuaj që nuk e keni kontaktuar asnjëherë drejtpërsëdrejti ju
20 Shtabin e Përgjithshëm gjatë kohës që keni punuar me zbulimin
21 dhe kundërzbulimin në Zonën Operative të Pashtrikut?

22 PË. Unë kam qenë tri herë gjatë luftës në Shtab të
23 Përgjithshëm. Kontaktimet e mia gjithmonë jam munduar t'i bëj
24 përmes komandës. Nuk më kujtohet ndonjëherë që të kem
25 kontaktuar direkt pa njoftimin e komandantit përpos ato

1 shkrime që i kemi lexuar dje [E pakuptueshme].

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur thoni komandanti, e keni
3 fjalën për komandant Drinin?

4 PË. Kur flas për komandën është komandant Drini, është
5 komandant Tahir Sinani, është komandant Sadik Halitjaha, janë
6 të gjithë pjesë e komandës së Zonës Operative të Pashtrikut.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo do të kishte qenë në
8 fakt pyetja ime e radhës. Pra, nuk kishte dallim mes kohës kur
9 ka qenë komandant Drini, komandant i Zonës Operative të
10 Pashtrikut dhe kur ishte Tahir Sinani komandant, dhe kur ka
11 qenë Sadik Halitjaha ka qenë zëvendëskomandant, nuk ka pasur
12 ndonjë dallim në këtë drejtim, kështu?

13 PË. Nuk e kuptova qëllimin e pyetjes. Nuk ka pasur dallim.
14 Dallimi ka qenë se ka qenë tjetër komandant Tahir Sinani,
15 tjetër Drini. Në kohën kur ka ardh Tahir Sinani komandant,
16 zëvendës i tij është bë, emërohet Sadik Halitjaha. Në kohën
17 kur erdhi Tahir Sinani kanë qenë zhvillimet shumë më të
18 shpeshta, luftimet më të shpeshta, janë shtuar. Nuk di çfarë
19 dallimi më konkret po e kërkoni. Ju lutem, nëse ka mundësi të
20 ma përcaktoni.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, në fakt, jo, e dhatë
22 përgjigjen. Thatë që nuk ka pasur dallim mes tyre. Mes tyre
23 nuk ka pasur dallim, kështu?

24 Kur ka qenë komandant Drini, komandant i Pashtrikut dhe
25 më pas Sinani u bë komandant, ju thatë dje se ju i keni

1 raportuar atyre - bazohem në deklaratën tuaj - edhe ju i jeni
2 referuar këtu edhe z. Reçica, komandant Drinit - më fal - z.
3 Rexha, komandant Drinit dhe Tahir Sinanit. Keni thënë që ishte
4 detyrë e komandantit të informonte dhe të raportonte në
5 Shtabin e Përgjithshëm. A e keni thënë këtë dje?
6 PË. Po, zotëri. Nëse ai do ta shifte të arsyeshme që të
7 raportojë ato që unë kam propozuar ose ato që unë kam njoftuar
8 komandën, ai kishte detyrë që të njoftonte Shtabin e
9 Përgjithshëm.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. Qadraku, a keni ndonjë arsye për të besuar ju se
12 komandant Drini ose Tahir Sinani nuk i kanë dërguar raportet
13 tuaja ose e thënë ndryshe, nuk e kanë informuar Shtabin e
14 Përgjithshëm lidhur me ato që ju keni treguar ju atyre gjatë
15 kohës që keni qenë në ZKZ në Zonën Operative të Pashtrikut?
16 PË. Atëherë kur unë e kam kuptuar se disa nga ato propozimet
17 e mia nuk kanë shkuar në Shtabin e Përgjithshëm, atëherë kam
18 shkruar një letër që e kemi cekur këtu dje dhe pardje, që jam
19 mundur në një mënyrë tjetër apo tërthorazi t'ja dërgoj Shtabit
20 të Përgjithshëm që ta njoftoj për ato ç'ka unë kam dashur ta
21 njoftoj. Kështu që domethënë, çdo herë besoj se ai ka
22 raportuar apo i ka treguar, por atëherë kur unë e kam kuptuar
23 se ai nuk ka treguar, unë besoj që atëherë ndoshta kam kërkuar
24 një rrugë tjetër për të lajmëruar Shtabin e Përgjithshëm,
25 përkatësisht, Bislim Zyrapin, për atë që unë e mendoj se kanë

1 qenë negative në Zonën Operative të Pashtrikut.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më shumë isha
3 i interesuar të dija diçka lidhur me një aspekt tjetër të
4 dëshmisë tuaj. Ju na keni thënë që detyra juaj, pra si shef i
5 inteligjencës ose i zbulimit apo si në detyrën tuaj në
6 sektorin e zbulim-kundërzbulimit në zonën e Pashtrikut, ishte
7 që të mblidhnit informacion lidhur me pozicionet serbe,
8 armatimet që ata kishin në dispozicion dhe aspekte të tjera të
9 ngjashme.

10 Dua t'ju pyes në qoftë se keni dëgjuar për ankesa të
11 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm që Shtabi i Përgjithshëm
12 nuk ka marrë informacion të rëndësishëm që ju kishit mbledhur
13 lidhur me armët apo me aspekte të tjera, pra, informacioni që
14 ju kishit mbledhur në njësinë e zbulim-kundërzbulimit.

15 Domethënë, a keni dëgjuar ndonjë ankesë që Shtabi i
16 Përgjithshëm nuk e ka marrë informacionin e mbledhur në zonën
17 tuaj operative?

18 PË. Unë nuk kam pasur ndonjëherë ndonjë ankesë nga asnjëri
19 komandant, as nga Ekrem Rexha, Drini, e as nga Tahir Sinani që
20 më është kërkuar apo që janë ankuar nga Shtabi i Përgjithshëm
21 për mungesën e raportimeve të mia mbi bazën -- pozicionet edhe
22 lëvizjet e armikut. Nuk ka pas kurrë ndonjë ankesë ndaj meje,
23 edhe besoj që kam qenë gjithmonë konsekuent edhe përgjegjës në
24 këtë drejtim, që i kam furnizuar me të gjitha informacionet që
25 atyre ju duheshin.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Mendoj që ky
2 aspekt është i qartë tani.

3 Tani do vijojmë me pyetje të tjera që kam për ju. Pyetjet
4 që kam tani kanë të bëjmë me shënimet e Shënimit Përgatitor
5 numër 2. Dhe lidhur me ato çfarë ju i keni thënë Prokurorisë
6 në seancën përgatitore përpara një jave.

7 Grupi i parë i pyetjeve që kam për juve, ka të bëjë me
8 informacionin që pasqyrohet në paragrafin 16 të seancës
9 përgatitore 2, që ju thoni që në maj ose në qershor të vitit
10 1998, me një grup që mbase përfshinte dhe Zyrabin pra, në
11 kohën kur ktheheni nga Shqipëria dhe në grup ishte edhe Hashim
12 Thaçi, që ai kishte me vete dy snajpera, dy armë snajpera.

13 Besoj që për këto dy armët snajpera të llojit snajper, e
14 keni fjalën kur keni bërë këtë cilësim, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po, ashtu e kujtoj unë se kishte dy snajper të vjetër rus
16 në shpinë. Edhe unë mendoj se ai ka qenë Hashim Thaçi. Më vonë
17 kur e kam njohur kush është, se në atë rrugëtim unë s'e kam
18 ditur kush është ai. Po mandej kam menduar, kam kujtuar --

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do kalojmë, do vijmë edhe te
20 kjo pikë. Faleminderit. Do kalojmë dhe te ky aspekt. Pra,
21 vazhdoni dhe thoni që z. Thaçi drodhi këmbën dhe pastaj ju
22 thoni që i morët snajperat e z. Thaçi dhe pastaj ju thoni që
23 z. Thaçi eci më tej. Më tej në këtë paragraf ju i thoni
24 Prokurorisë që nuk e dinit që z. Thaçi i ishte dhënë mandati
25 që të krijonin struktura e luftës. A ju kujtohet ta keni thënë

1 këtë për Prokurorinë, Dëshmitar?

2 Ja keni thënë Prokurorit këtë përpara një jave?

3 PË. Po, zotëri, e kam thënë edhe atëherë edhe sot nuk e di që
4 ai kishte detyrë që ta formonte UÇK-së apo që të krijonte
5 diçka.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tani, a e dini, 25 vite
7 më pas se çfarë pozicioni ka pasur z. Thaçi në maj dhe në
8 qershor të vitit 1998, në qoftë se ka pas ndonjë pozicion?
9 Keni ndonjë dijeni tani, sot?

10 PË. Jo, zotëri, nuk e di as sot. Për q'atë kohë nuk e di. Për
11 më vonë e di që ka qenë në atë strukturën diplomatike të
12 udhëheqje politike të UÇK-së. Por për në atë kohë ende nuk e
13 di se çfarë ka qenë, apo kanë qenë të emëruar pozicionet e
14 tyre.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini tani në qoftë se z.
16 Thaçi ka qenë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ose
17 të Shtabit Qendror, siç e ka pas emrin atëhere, siç e kemi
18 dëgjuar këtu përpara sesa të quhej Shtabi i Përgjithshëm? Pra,
19 ka qenë Shtabi Qendror përpara sesa të quhej Shtabi i
20 Përgjithshëm. A e dini në qoftë se ai ka qenë anëtar i Shtabit
21 të Përgjithshëm të UÇK-së ose i Shtabit Qendror të UÇK-së,
22 Dëshmitar?

23 PË. Nuk di çfarë të them. Nuk më -- ende -- ne të gjithë këta
24 shokët tani që janë përmendur pas luftës, të gjithë i
25 perceptojmë si anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, si Azem

1 Sylën, si Xhavit Halitin, si Hashim Thaçin, si Rexhep Selimin,
2 si Jakup Krasniqin, si Kadri Veselin. Domethënë, nuk di më as
3 nuk mund të them sot me saktësi sa anëtarë kishte Shtabi i
4 Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo Shtabi
5 Qendror i cili ashtu quhej deri në një kohë. Kështu që nuk di
6 me saktësi të them a ka qenë.

7 Mirëpo perceptimi im si një luftëtar, gjithmonë e pranoj
8 të gjithë këta emra i pranoj si anëtarë të Shtabit të
9 Përgjithshëm pavarësisht çfarë detyre kanë pasur brenda saj.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Qadraku, a
11 e dini ose a keni ndonjë njohuri në qoftë se z. Veseli dhe z.
12 Thaçi kanë punuar për sa i takon organizimit të UÇK-së
13 ndërmjet të tjerave duke bërë ndërlidhjen ndërmjet Shtabit
14 Qendror ose Shtabit të Përgjithshëm, të anëtarëve të Shtabit
15 Qendror ose Shtabit të Përgjithshëm në Kosovë dhe të tjerëve
16 që ishin -- nuk ishin në Kosovë ishin jashtë gjatë luftës.

17 A keni ndonjë njohuri lidhur me këtë? Përpara luftës.
18 PY. Unë nuk kam njohuri personale për këtë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kalojmë tek
20 faqja 6 e seancës përgatitore, shënimit të kësaj seance, tek
21 paragrafi 16, përsëri. Ju thoni, dhe kam përshtypjen që e keni
22 përsëritur dhe dje këtë gjatë pyetjeve të bëra nga palët. Pra,
23 në Shënimin Përgatitor 2 thuhet si më poshtë: "Ka pasur
24 autonomi sa i takon organizimit dhe ju mendoni që kjo ka
25 ndodhur në të gjitha regjionet sepse ju nuk mund të detyronit

1 askënd që të krijonte UÇK-në". Lidhur me atë se çfarë ka
2 ndodhur në zonën tuaj ju thoni që besoni se në çdo komunë ka
3 pas një person i cili e ka filluar punën vetë dhe me kohë ata
4 kanë organizuar njerëzit.

5 Për të qenë i qartë lidhur me dëshminë tuaj për këtë
6 aspekt, z. Qadraku, a ke dashur të thuash që sipas mendimit
7 tënd, Shtabi i Përgjithshëm nuk ka qenë i përfshirë në
8 organizimin e strukturës së UÇK-së për këtë periudhë? Pra, për
9 majin, qershorin 1998 ose përpara kësaj periudhe? Këtë po
10 thoni që Shtabi i Përgjithshëm nuk ka qenë fare i përfshirë?
11 PË. Unë mendoj se Shtabi i Përgjithshëm nuk ka mundur të
12 organizojë të gjitha organizimet nëpër fshatra nëpër terrene,
13 por gjithmonë ka pas një njeri. Unë mund ta marr shembull
14 vetëm veten një herë, e atëherë të nisemi nga kjo, që mund të
15 kuptojmë se ndoshta kështu ka mund të ndodh edhe nëpër vende
16 të tjera.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 17 të Shënimit
18 Përgatitor 2, më korrigjoni në qoftë se e kam gabim, por këtu
19 ju konfirmoni që Shtabi i Përgjithshëm apo siç quhej në atë
20 kohë Shtabi Qendror ekzistonte që përpara luftës. A është e
21 vërtetë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Unë si mërgimtar në Zvicër për Shtabin Qendror kam lexuar
23 nëpër gazeta edhe ndoshta dhe ka ekzistuar para luftës, por
24 nuk s'kam pas njohuri se kush janë edhe sa janë. Por që kemi
25 lexuar nëpër revistat tona, kemi pas Zërin tonë të Kosovës

1 atje të Zvicrës, kështu që ndoshta këto njohuri mund t'i kem
2 marrë nga leximet e jo nga njohuritë e mia dhe nga kontaktet e
3 mira personale.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Keni konfirmuar
5 gjithashtu apo keni thënë që emërtimi UÇK është dhënë me 16
6 nëntor 1994, prapë këtu i referohem paragrafit 17 të Shënimit
7 Përgatitor numër 2. A është e saktë kjo, Dëshmitar, a e keni
8 thënë këtë?

9 PË. Po, zotëri. Unë e kam thënë, ndoshta kam gabu me një datë
10 se është -- ashtu kemi dit, ashtu kemi lexu, ashtu na kanë
11 tregu shokët se me 17 nëntor 1994, është propozue nga shokët
12 emërtimi Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Është propozu që ajo
13 ushtri, ai grup i armatosur apo ato grupe të armatosura, apo
14 bashkimi i atyne grupeve të armatosura do të mblidhet rreth
15 emrit, Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Pra është ashtu.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush e vendosi këtë? Pra,
17 kush e vendosi që grupi ose organizata do të merrte emrin ose
18 emërtimin Ushtria Çlirimtare e Kosovës? A ke dijeni lidhur me
19 këtë?

20 PË. Unë prapë po ju them që nuk kam dijenitë e mia direkte.
21 Të gjitha dijenitë e mia janë të lexuara më vonë pasi që ato
22 janë vu në veprim si të tilla. Por dijeni time direkte me atë
23 grup shokësh që e kanë bërë këtë, nuk kam.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë që dijenia juaj
25 është marrë në një fazë më të vonë, ose e keni marrë nga

1 leximet që keni bërë më pas. A dini ju se kush e ka vendosur
2 që grupi të merrte emërtimin Ushtria Çlirimtare e Kosovës
3 atëherë? Keni ndonjë informacion lidhur me këtë?
4 PË. Po nga ato që kam lexuar unë mendoj se ka qenë ndoshta
5 kryesia e Lëvizjes Popullore të Kosovës ose ai grupi për
6 veprime të veçanta që edhe ata kanë qenë pjesë e kryesisë së
7 Lëvizjes Popullore të Kosovës, por konkretisht cili ka
8 propozu, nuk e di me emër e asi. Kaq di. Po e di që ata e kanë
9 [E padëgjueshme].

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetjet e
11 radhës kanë të bëjmë me paragrafin 21 të Shënimit Përgatitor
12 numër 2. Në këtë paragraf ju flisni për një person që quhet
13 Sabit Geci. Ju thoni që e keni parë z. Geci në Shqipëri në
14 verën e vitit 1998 kur keni shkuar për të vizituar një spital
15 me një mjek që e njihnit prej Zvicre. Ju thoni që ishit me
16 UÇK-në dhe ishe përgjegjës për të ndihmuar personat e
17 plagosur. Ju thoni gjithashtu që jeni takuar me z. Geci dhe
18 pas luftës dhe që ju të dy jeni -- keni qenë të ndaluar në të
19 njëjtën kohë. Këtë i keni thënë Prokurorisë gjatë seancës
20 përgatitore, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po, zotëri.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni,
23 Dëshmitar, se çfarë roli ka pasur z. Geci në UÇK, në qoftë se
24 ka pasur ndonjë rol?

25 PË. Jo, zotëri. Unë nuk mund të them se çfarë roli ka pas, se

1 vetëm një herë e kam takuar kalimthi. Kam qenë në vizitë te
2 shokët e plagosur në spitalin e Tiranës. Nuk di çfarë detyre
3 ka pas Sabit Geci në Ushtrinë Çlirimtare e Kosovës.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ju pyes sepse siç keni
5 thënë vetë, z. Qadraku, ju keni qenë i ndaluar dhe keni
6 qëndruar me të në të njëjtën kohë, dhe po mendoja që ndoshta
7 keni biseduar me njëri-tjetrin në atë kohë lidhur me atë se
8 çfarë keni bërë gjatë luftës. Për këtë arsye po ju pyes. Pra,
9 pyetja ime tani është kjo: Domethënë, ju nuk keni folur
10 asnjëherë, nuk e keni pyetur asnjëherë z. Geci rreth asaj kohe
11 të luftës ose më pas luftës se çfarë ka bërë ai gjatë luftës,
12 çfarë roli ka pas ai?

13 PË. Zotëri Gjykatës, kur jam arrestuar unë në vitin 2001, nuk
14 kam qenë me të njëjtin rast me Sabit Gecin, por është
15 arrestuar edhe ai në Prishtinë, nuk e di se çfarë rasti.
16 Mirëpo dua t'ju them një, në ato burgje ku ne kemi vuajtur
17 atëherë, shumë kemi qenë rreptësisht të ndaluar të komunikojmë
18 secili ushtar i UÇK-së me një tjetër ushtar të UÇK-së. Policia
19 e UNMIK-ut na kishte izoluar të gjithëve njëri nga tjetri.
20 Kemi pas një trajtim shumë të rreptë që mos të shifemi dhe mos
21 të kontaktojmë njëri me tjetrin.

22 Unë me Sabit Gecin veç kam mundur ta shoh nga dritarja
23 kur ai dilte në shëtitore ose kur unë dilja në shëtitore ai të
24 më shihte mua. Por, që të flasim mes vete, që të rrimë mes
25 vete, nuk kemi pasur këtë mundësi.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, në qoftë se e kuptoj
2 drejtë atë që çfarë thatë, ju nuk e dini në qoftë se z. Geci
3 ka qenë ose ka pas ndonjë përfshirje, është marrë me shërbimet
4 e zbulim-kundërzbulimit gjatë luftës? Domethënë nuk keni asnjë
5 informacion lidhur me këtë, kështu?

6 PË. Unë një e di se Geci e kam pa në Shqipëri. Nuk e di në
7 Kosovë kurrë s'e kam pa gjatë luftës Gecin, Sabitin. Edhe nuk
8 di a ka qenë në Kosovë ndonjëherë. Nuk e di për atë. Por, s'e
9 kam parë kurrë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Përpara sesa
11 të bëjmë pushimin kam dy pyetje të shkurtra lidhur me
12 paragrafin e radhës, që është paragrafi 22 i shënimit
13 përgatitor. Në këtë paragraf ju konfirmoni se është e saktë se
14 ndërkohë që ju ishit shefi i G2-shit keni mbledhur informacion
15 brenda UÇK-së për të gjetur se ku ishin armiqtë, pozicionet e
16 tyre dhe çfarë lloj armësh kishin ata.

17 Dua të më shpjegoni dhe të më thoni se çfarë keni dasht
18 të thoni kur keni thënë që ju keni mbledhur informacion brenda
19 UÇK-së. Çfarë keni dasht të thoni me këtë, Dëshmitar, në qoftë
20 se e keni thënë këtë gjë? Në qoftë se ja keni thënë këtë
21 Prokurorisë, çfarë keni dashur të thoni me këtë?

22 PË. Po, zotëri Gjykatës. Territori ynë ku ne qëndronim ishte
23 i kufizuar me rrugë kryesore të cilat zotëroheshin edhe
24 kontrolltoheshin nga forcat serbe. Të gjithë ushtarët tanë të
25 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ishin rojet e para pranë

1 atyne rrugëve kryesore që ishin edhe vëzhgues të atyne
2 lëvizjeve të forcave serbe në njëerën apo tjetrën anë, ishin të
3 obliguar që ata të raportojnë te komanda e tyre, e komanda e
4 tyre të raportojë tek ne që në çdo moment të dimë kah lëvizin,
5 sa forca lëvizin, çfarë forca lëvizin. Kështu që në këtë
6 aspekt kam thënë që mbrenda UÇK-së ne kemi mbledhur
7 informacione për lëvizjet serbe nga vetë ushtarët e UÇK-së që
8 ishin në vijat e para ndarëse.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Nuk e di,
10 besoj që ka ardhur momenti për të bërë pushimin.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do bëjmë
12 pushim për gjysmë ore, Dëshmitar. Do kthemi përsëri në sallë
13 në orën 11.40, domethënë 12 -- jo, ju kërkoj ndjesë. Do vijmë
14 në orën 12.10. Se nuk e pashë mirë orën. Do vazhdojmë atëherë
15 me pjesën tjetër.

16 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
17 këshillohen]

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] atëherë do
20 bëjmë pushim deri në orën 12 pa 10. Do bëjmë pushimin tani dhe
21 do shihemi për pak.

22 --- Pauza fillon në orën 11.21

23 --- Seanca rifillon në orën 11.51

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Videoja që e
25 pranuan sot paradite, që kishte një numër provizor prove sot,

1 duhet që të riklasifikohet si publike.

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
3 Gjykatës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
5 sillni dëshmitarin në sallë.

6 [Dëshmitari vijon dëshminë]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Dëshmitar, do vazhdojmë
8 më tej me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, dhe mirë se u
10 kthyet z. Qadraku dhe z. Koci.

11 Tani do të kalojmë në paragrafin 25 të Shënimit
12 Përgatitor numër 2. Sipas këtij paragrafi, ju keni thënë si më
13 poshtë, Prokurorisë në seancën përgatitore, Dëshmitar. Dhe
14 këtu citoj:

15 "Anëtarët e UÇK-së afër kufijve me forcat armike, kishin
16 postblloqe, ku përcaktoheshin identitetet e personave të
17 cilët, ose futeshin ose largoheshin prej aty. Sigurisht që në
18 ato postblloqe kishte emra të njerëzve, të anëtarëve të UÇK-
19 së, të cilët, anëtarët e UÇK-së nuk do të donin që të futeshin
20 në territoret e tyre, sepse në një mënyrë ose në një mënyrë
21 tjetër ata kishin humbur besimin te këta persona, të cilët
22 mund të dëmtonin veprimtaritë e UÇK-së, duke parë se sa
23 anëtarë të UÇK-së kishte dhe duke marrë informacion të
24 ngjashëm."

25 Dhe këtu përfundon citimi. Z. Qadraku, dua të më thoni,

1 këtua e keni fjalën për personat që kanë bashkëpunuar me
2 armikun duke i dhënë informacion forcave armike lidhur me UÇK-
3 në? Për këtë e keni fjalën në këtë përshkrim?

4 PË. Këtua e kisha fjalën për ata persona që punonin ende si në
5 policinë e Serbisë, si ishin në një mënyrë të lidhur me
6 pushtetin okupator të asaj kohe. Ka mund të jetë gjyqtar, ka
7 mund të jetë prokuror, ka mund të jetë hetues, ka mund të jetë
8 gardian, ka mund të jetë polic, ka mund të jetë pjesë e ndonjë
9 administrate të asaj aparature okupatore, kështu që ne e
10 ruanim territorin tonë dhe vetveten nga ata.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë të qartë lidhur
12 me këtë pikë, nuk ishte e rëndësishme në qoftë se këta persona
13 ishin serbë apo ishin shqiptarë. Kështu? Është e vërtetë kjo?
14 PË. Nuk kishte rëndësi. Me rëndësi ishte që të ishin pjesë e
15 asaj aparature okupatoriale.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në të njëjtin
17 paragraf thuhet që ju i keni thënë Prokurorisë që anëtarët e
18 UÇK-së dinin emrat e personave, e shumë personave të cilët
19 kanë punuar kundër interesave të tyre. Dhe thoni më tej që 70%
20 e atyre që kanë keqtrajtuar ose torturuar, të burgosurit në
21 vitet '70 dhe në vitet '80 ishin shqiptarë, "dhe për këtë
22 arsye pjesëtarët e UÇK-së ishin të frikësuar edhe për shkak të
23 tjerë".

24 A ja keni thënë këtë gjë Prokurorisë, Dëshmitar? A është
25 e saktë kjo?

1 PË. Po, zotëri Gjykatës, krejt këto fjalë i kam thanë
2 Prokurorisë dhe prapë mendoj, prapë mendoj se 70% të asaj
3 aparature okupatore nga viti 1945 e deri në 1999 ka qenë
4 shqiptare.

5 Fatkeqësisht, edhe ne ata emra i kishim të njohur sepse
6 ishim rrahur nga ata. Ishim burgosur nga ata, ishim trajtuar
7 keq nga ata, prandaj nuk donim që të na bënë dëm ende në
8 ditët e çlirimit e në ditët e luftës.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Kush në UÇK ka
10 vendosur në qoftë se një person nuk lejohej që të futej në
11 territor, sepse personi në fjalë që mund të ishte ai ose ajo,
12 mund të dëmtonte veprimtaritë e UÇK-së? Kush e përcaktonte
13 këtë? Kush e vendoste këtë?

14 PË. Së pari, në bazë të informacioneve që mund ta merrnim nga
15 një shok apo nga një dikush, do ta merrja unë atë, do ta
16 diskutonim së bashku me komandën edhe normalisht, e sipas
17 propozimit tim, do të vendoste komandanti i zonës, e ai mund
18 t'ia jepte atë komandantit të brigadës. Komandanti i brigadës
19 mbase mund t'ia jepte atje te postblloku apo te ushtari i
20 thjeshtë, kush do ta -- domethënë, merrnim vendim të
21 përgjithshëm. Të gjithë ne ishim të interesuar të ruajmë
22 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, të ruajmë territoret tona, të
23 ruajmë popullatën tonë. Nuk ishte vendim i një njeriu apo i
24 një --

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, kjo është ajo çfarë ka

1 ndodhur në realitet, faktikisht, pra mënyra se si ju e
2 përshkruat procedurën. Kjo është ajo çka ka ndodhur në
3 realitet. Kështu është, Dëshmitar?

4 PË. Unë nuk kam njohur një metodë më të mirë për ta ruajtur
5 veten, për ta ruajtur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe për
6 ta ruajtur atë territorin tonë ku ne ishim. Kam menduar që
7 kështu mund ta ruajmë veten.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Qadraku, në paragrafin 27
9 të Shënimit Përgatitor 2 thoni te fjalia e fundit si më
10 poshtë, dhe këtu citoj:

11 "Disa vende kanë pranuar dëmtimin kolateral po asnjë
12 dëmtim kolateral ose i përgjithshëm nuk është konsideruar
13 lidhur me UÇK-në sepse çdo gjë është konsideruar si krim."

14 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorisë? Ju lutem,
15 në qoftë se e keni thënë, na e shpjegoni se çfarë keni doni të
16 -- keni dashur të thoni me këtë fjali?

17 PË. Me këtë fjali unë kam dashur të them se në ato kushte
18 lufte, në ato kushte zjarri, në ato kushte vrasjeje, ne kishim
19 shumë viktima në fëmijë, në gra, në pleq. Kishte mundësi që
20 secili njeri, sepse ne njerëz ishim, secili njeri ndoshta
21 ndonjëherë në ndonjë moment të caktuar të dalë dhe nga
22 vetvetja. Secili njeri kishte mundësi që të tjetërsohej para
23 një krimi të parë me sytë e tij. Kështu që secili njeri ka
24 mundur në një mënyrë apo tjetër, duke mos potencuar saktësisht
25 se çfarë, po ka mundur ose ta shikoj dikë me shtrembër, ose

1 t'i bërtasë dikush dikujt "largohu nga këtu" ose në një ton
2 pak më të ashpër, edhe domethënë që disa këto unë i quaja dëme
3 kolaterale që mund të njeriu t'i bëjë në afektin e gjakut.

4 Edhe shkrimet e mia -- edhe shkrimet e mia, edhe
5 propozimet e mia që unë i kam bërë komandës së zonës operative
6 të Pashtrikut, kanë qenë të gjitha në afekt. Sot ndoshta me
7 këtë -- me këtë situatë dhe me këtë njohuri, ndoshta nuk do të
8 kisha shkruar, por në atë kohë ka qenë çështje e afektit, ka
9 qenë çështje e shumë trazirave, vrasjeve, viktimave që kishim.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Qadraku, supozojmë se një
11 person gabimisht dyshohej si bashkëpunëtor dhe mbahej i
12 ndaluar ky person nga UÇK-ja, nga ushtarët e UÇK-së,
13 keqtrajtohej, madje edhe mund të vritej. Këtë rast, këtë
14 person, do ta konsideronit dëm kolateral ju?

15 PË. Jo, zotëri.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po pse? Pse ky
17 person nuk do të konsiderohej dëm kolateral?

18 PË. Po ju vetë e thatë, nëse ai person do të mbahej, nëse ai
19 person do të keqtrajtohej, domethënë, paska pas kohë, paska
20 pas hapësirë që të mendoj më - unë ato më herët që fola në
21 afekt, afekti është momental. Momental mund njeriu me gabu
22 diçka dhe të thotë diçka dhe të veprojë diçka.

23 Kurse nëse paska --ka pas hetime, nëse ka pas
24 keqtrajtime, nëse ka pas mbajtje e mandej edhe është vrarë,
25 atëherë më nuk është afekt. Është një hetim me qëllim dhe kaq

1 është ajo. Me -- duke cituar fjalën e juaj, të supozojmë, dhe
2 unë fola me supozime.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin.
4 Z. Qadraku, tani do doja të flisnim për një temë tjetër. Do të
5 doja të flisnim për atë që i keni thënë Prokurorisë në
6 paragrafin 36 të shënimit përgatitor. Në shënimin përgat -- në
7 këtë paragraf, keni përmendur disa persona, mes të cilëve keni
8 përmendur edhe z. Thaçi dhe z. Kadri Vesli dhe keni thënë që
9 kanë qenë pjesë, bashkë me persona të tjerë kanë qenë pjesë e
10 strukturave diplomatike të UÇK-së që merreshin kryesisht me
11 takime dhe veprimtari ndërkombëtare brenda kuadrit diplomatik.
12 Dhe nuk merreshin shumë me çështje që lidheshin me luftën në
13 terren në Kosovë. Pyetja ime e parë është, a ju kujtohet ta
14 keni thënë këtë për Prokurorinë?

15 PË. Po, zotëri Gjykatës, më kujtohet.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani dëshiroj t'iu pyes nga
17 e dini ju që z. Thaçi dhe z. Veseli kanë qenë pjesë e
18 strukturave diplomatike, që sapo -- pra, sapo u përgjigjët
19 lidhur me këtë? Sepse ju një herë keni thënë që nuk e keni
20 njohur z. Thaçi dhe z. Veseli në kohën kur keni qenë në Zvicër
21 në periudhën maj-qershor të vitit 1998, dhe nuk e kishit të
22 qartë se çfarë bënin ata. Këtë ne ke -- e keni thënë një herë,
23 por tani po thoni dhe e konfirmoni që ju e dinit se ata ishin
24 pjesë e strukturave diplomatike dhe se merrnin pjesë në takime
25 dhe veprimtari ndërkombëtare. Pyetja ime është: Ku e bazoni ju

1 këtë deklaratë?

2 PË. Po të më kishin pyetur në vitin 1998-1999 ndoshta nuk do
3 ta dija, por meqenëse jam pyetur në vitin 2019 dhe në 2024, ju
4 thashë edhe parëz, që tani njohuritë tona bazohen në ato çka
5 kemi parë gjatë luftës, në ato çka kemi parë pas luftës, në
6 ato çka kemi lexuar. Kështu që atë fjalën time e bazoj sepse
7 të gjithë ata që kanë qenë përgjegjës të Shtabit të
8 Përgjithshëm të flasin, të gjithë ata e kanë thënë këtë.

9 Mandej, dua t'ju them edhe një gjë. Që 25 vjet shtypi
10 kosovar është i mbingarkuar me lloj-lloj shkrimesh. Si
11 pozitive, si negative. Në asnjë gazetë, as të kundërshtarëve,
12 e as të tonat, nuk kam lexuare t'i thuhet Hashim Thaçit
13 "Gjeneral Hashim Thaçi". Në asnjë gazetë, libër, nuk ka
14 Gjeneral Kadri Veseli. Dhe kjo e dëshmon se ata nuk kishin
15 aktivitet të tyre ushtarak, operacional nëpër terrene gjatë
16 luftës në vitin 1998-99, por kishin më shumë detyrat e tyre të
17 kontaktonin me strukturat ndërkombëtare.

18 Krejt këto i bazoj, prapë po them, nga ato që kam parë e
19 dëgjuar, po jo nga kontaktet e mia me Shtabin e Përgjithshëm
20 apo nga atje. Janë të lexuara, të dëgjuara.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. Qadraku, në paragrafin 37 keni thënë se gjatë luftës
23 z. Thaçi dhe z. Veseli, dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të
24 Përgjithshëm të UÇK-së, udhëtonin shpejt drejt e nga Shqipëria
25 dhe më shumë se 40 herë madje, dhe çdo udhëtim zgjaste një a

1 dy javë. Këtë nga e dini? A keni lexuar në ndonjë gazetë? Apo
2 e keni mësuar prej ndokujt? Pse besoni ju që ata kanë udhëtuar
3 më shumë se 40 herë drejt Shqipërisë dhe nga Shqipëria drejt
4 Kosovës, dhe se çdo udhëtim zgjaste një ose dy javë? Ku e
5 bazoni këtë?

6 PË. Ju kam thënë edhe Prokurorisë edhe juve, se unë e kisha
7 kontakte me shokët e Brigadës 126, shokët nga Hasi, që ishin
8 më shumë të orientuar vetëm për të drejtuar kalimet kufitare
9 andej-këtej. Këto njohuri për sasinë, jemi kah flasim njëherë,
10 që kam thënë që mbi 40 herë, këto njohuri i kam ndoshta nga
11 ata, duke më treguar se "unë kam përcjellë këtë herë, unë e
12 kam përcjellë këtë herë apo atëherë", domethënë e kam më shumë
13 nga vetë ushtarët tanë.

14 Kurse çështje atë që kohëzgjatja e tyre ka zgjatur me
15 javë, unë këtë e kam thënë më duket vitin e kaluar në një
16 televizion publik. Vërtetë ndoshta vetëm kalimi i kufirit
17 zgjat një ditë apo 24 orë nga ana e jonë, mirëpo, të afrohesh
18 deri te kufiri i kësaj ane të Kosovës, dhe të largohesh nga
19 pjesa e Cahanit, kur të kalon Shqipërinë, edhe ajo do atë
20 kohën e vet. Të shkosh deri atje ku duhet të shkosh, në
21 Bruksel, apo në Uashington, apo në Vjenë apo në Londër, këto
22 kanë qenë ato supozimet e mia që kam fol, se secili udhëtim i
23 tyre ka mujt të zgjasë një javë, dy javë, deri te takimet me
24 ndërkombëtarë, jo ndonjë udhëtim specifik që unë kam ditur,
25 apo diçka. Kam folur në përgjithësi, se kështu duhet të

1 ndodhte. Aq kohë i vyen, i duhet dikujt që të shkojë deri në
2 Evropë, apo nga Evropa deri në Kosovë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Qadraku. Po
4 të bëjmë llogarinë, dhe themi 40 udhëtime, shumëzim 1 javë e
5 gjysmë, dalin më shumë se 60 javë, që i takon pothuajse një
6 vit. Prandaj po ju pyesja. Pra ju po thoni që z. Thaçi dhe z.
7 Veseli nuk kanë qenë në Kosovë për më shumë se një vit? Apo po
8 thoni që kanë qenë? Po ju pyes, po të bësh llogaritë.

9 PË. Tani, kjo -- tani ju po llogarisni në mënyrë
10 matematikore. O unë nuk e kam llogarit se cili udhëtim ka
11 zgjat një javë, dy javë. Ka -- ndoshta një udhëtim ka zgjat
12 një ditë, ndoshta një udhëtim dy ditë. Po e merrni pak më
13 ndryshe, por një e di se të gjithë ato takime që unë ndoshta
14 unë nuk mund t'i dokumentoj. Ju do të mund t'i dokumentoni
15 takimet e tyre që i kanë pasur me ndërkombëtarë. Do ta shihni
16 edhe vetë se është shumë e vërtetë se ata kanë udhëtuar
17 shpesh. Mandejne, e di, kam parë një deklaratë të komandantit
18 të ushtrisë serbe pas luftës, kur pati thënë se gjatë luftës
19 nuk ka qenë një Hashim Thaç. Ai thoshte jam i bindur se janë
20 tre, sepse nuk është e mundur sot të jetë në Kosovë, nesër të
21 jetë në Tiranë, pasnesër të jetë në atyne."

22 Domethënë, këtë -- të gjitha këto fjalë tani te unë janë
23 bazuar te të gjitha këto njohuri, jo diçka specifike, jo diçka
24 matematikore, siç ma cekët ju.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, besoj që e

1 bëtë të qartë.

2 Tani do shohim paragrafin 40 të Shënimit Përgatitor numër
3 2, ku keni thënë se çdo herë që keni qenë në Nishor, ku ishte
4 edhe komanda e zonës, pra e zonës së Pashtrikut, ju
5 personalisht dhe të tjerët bënit, mbanit mbledhje në orën
6 09.00 të mëngjesit. Pavarësisht se kishit a nuk kishit
7 informata për të raportuar, dhe po në këtë paragraf keni thënë
8 që të gjithë shefat e sektorëve -- seksioneve G që ishin të
9 disponueshëm, merrnin pjesë në këto takime, dhe do të thoshit
10 diçka -- do thoshit gjithçka që kishit për të raportuar në
11 praninë e të gjithë personave që ishin pjesë e strukturës
12 komanduese, sepse ju besonit se komandanti duhej të informohej
13 për çdo gjë, qofshin këto raportime pozitive, negative apo
14 qoftë e thjeshtë opinionet tuajat. Ju kujtohet që e keni thënë
15 këtë?

16 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, është e drejtë të them
18 që ishte e rëndësishme për ju që komandanti juaj fillimisht
19 komandant Drini, e më pas komandant Sinani, por edhe
20 komandantë të tjerë, pra për ju ishte e rëndësishme që ata të
21 ishin të informuar dhe të përditësuar lidhur me veprimtaritë e
22 seksionit tuaj të ZKS-së. Është ky një përshtkrim i drejtë?

23 PË. Po, zoti Gjykatës, mendoj është e drejtë.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen tjetër të
25 paragrafit 40 ju thoni diku në mes të faqes, se keni dërguar -

1 - i keni dërguar letra Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së
2 përmes komandës së zonës dhe i keni çuar pothuajse çdo ditë
3 këto letra lidhur me atë që keni parë dhe që keni përjetuar,
4 sepse ju besonit që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së duhet të
5 merrte një kopje. Ju kujtohet që ja keni thënë këtë
6 Prokurorisë?

7 PË. Po, zotëri Gjykatës.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani dëshiroj t'iu pyes, a
9 mund të themi atëherë që ishte e rëndësishme për ju që edhe
10 Shtabi i Përgjithshëm të informohej lidhur me gjithçka që
11 ndodhte në zonën tuaj të përgjegjësisë, ose siç e keni thënë
12 ju me fjalët tuaja: "të informohej lidhur me ato që ju keni
13 parë, dhe keni përjetuar çdo ditë".

14 PË. Zoti Gjykatës, të gjitha kopjet që i kam bërë unë, i kam
15 bërë me vetëdije. Kopjen që e kam shtypur, një kopje për
16 Shtabin e Përgjithshëm, atë -- për atë ka mund të vendos
17 komandanti i zonës operative të Pashtrikut nëse duhet t'i
18 interesoje Shtabit të Përgjithshëm, apo jo. Por nëse i duhet,
19 nuk ka pas nevojë që ta rishtypë, e kishte kopjen të gatshme
20 nga unë për ta dërguara. Nëse jo, ka mujt ta mbajë. Ishte
21 vendimi plotësisht i tij, kishte autonominë e tij për të
22 vepruar, për të urdhëruar dhe -- ose për të na ndaluar në këtë
23 drejtim që mos veproni kështu, apo mos ashtu.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptova këtë z. Qadraku,
25 por unë po ju pyesja për ju personalisht, për ju personalisht,

1 ishte e rëndësishme që të informoje Shtabin e Përgjithshëm
2 lidhur me përvojën tuaj me atë që kishit parë, që kishit
3 vëzhguar ju vetë? Ju personalisht, e kishit të rëndësishme
4 këtë pjesë?

5 PË. Patjetër që po. Dhe kam menduar se ka një strukturë --
6 unë kam menduar se Shtabi i Përgjithshëm e ka një strukturë të
7 mirë organizuar që do t'i merrte të gjitha këto raporte tona
8 që i dërgojmë nga terreni që do t'i analizonte, që ta ketë një
9 pasqyrë më të qartë të lëvizjeve të çfarëdollojshme të
10 armikut. Kështu që unë kam menduar se ai informim i imi duhet
11 të përcillet deri atje. Po mos ta kisha menduar, nuk do ta
12 kisha shtypur edhe një kopje për ta.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptova. Z. Qadraku, në
14 intervistën që keni dhënë për ZPS-në në dhjetor të vitit 2019,
15 i referohem pjesës së intervistës, faqet 18 dhe 19, ju keni
16 thënë si në ijim. Po ju lexoj atë që keni thënë ju, të paktën
17 sipas transkriptimit. Keni thënë:

18 "Tahir Sinani, si komandant zone, ka qenë përgjegjës për
19 të mbrojtur një pjesë të territorit. Pra të gjitha këto G-të,
20 sektorët G, e informonin Tahir Sinanin lidhur me ato që
21 kishin, informacionet që kishin. Të gjithë informonin për
22 zonën, fushën e operacioneve, dhe bëhej një analizë për këtë,
23 dhe informacioni ishte një informacion i përbashkët ky, por në
24 varësi të kapaciteteve që kishim. Ndërsa Kadri Veseli dhe
25 Shtabi i Përgjithshëm kishte të njëjta përgjegjësi, të

1 informonte Azem Sylën, siç bëja dhe unë. Dhe dua të shtoj
2 fjalën këtu 'detyrim', se më duket se mungon fjala 'detyrim'
3 këtu. Pra, siç keni thënë edhe ju, kisha për detyrim të
4 informoja Tahir Sinanin. I vetmi dallim është që në këtë rast
5 nuk ishte nevoja të raportohet vetëm për një zonë të caktuar,
6 por në këtë rast dallimi ishte që duhej të informohet për të
7 gjitha zonat operative të Kosovës."

8 Tani, Z. Qadraku, unë do t'iu pyes: A pajtoheni ju me mua
9 që në bazë të deklaratës suaj, ka qenë edhe më e rëndësishme
10 që të informohet Shtabi i Përgjithshëm lidhur me ato që po
11 ndodhnin në shtatë zonat operative?

12 PË. Unë e kam menduar ashtu. Unë e kam menduar se ashtu do të
13 duhej të ishte, siç e kishim neve në zonën operative të
14 Pashtrikut, të kishin edhe ata në Shtab të Përgjithshëm.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thjesht doja mendimin tuaj,
16 në fakt, pikëpamjen tuaj lidhur me këtë, të cilën në fakt sapo
17 ma dhatë. Në rregull, atëherë. Faleminderit.

18 Do të kaloj tani te një temë tjetër. Është një paragraf
19 tjetër në Shënimin Përgatitor numër 2, është paragrafi 44. Në
20 këtë paragraf keni folur për marrëdhëniet që kishte UÇK-ja me
21 FARK-un. Është përmendur edhe dje kjo gjë -- pyetjeve që ju
22 bënë palët.

23 Dhe në seancën përgatitore ju keni thënë se në atë kohë,
24 pra, por edhe tani, keni besuar se FARK-u ishte krijuar për të
25 sabotuar UÇK-në. Z. Qadraku, e konfirmuat në fakt këtë dje,

1 dhe e ritheksuat. A mund t'iu pyes nëse është ende ky mendimi
2 juaj? Pra, që FARK-u u krijua për të sabotuar UÇK-në? Mjafton
3 një "po", ose "jo".

4 PË. Po, zotëri Gjykatës.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Më tej ju keni
6 thënë, të paktën sipas shënimit përgatitor, keni thënë se keni
7 qenë i përfshirë në një komision që vlerësonte kërkesat për
8 statusin e veteranit në vitin 2015, dhe ti nuk i pranoje
9 kërkesat që vinin nga FARK-u, sepse ata nuk kanë qenë
10 luftëtarë në Kosovë. Ja keni thënë vërtetë këtë Prokurorisë?
11 Dhe nëse po, i qëndroni ende kësaj?

12 PË. Po, zotëri. I kam thënë dhe prapë qëndroj ashtu. Nuk e
13 kanë merituar të jenë ashtu. Ata që s'ishin në Kosovë në
14 luftë. Nuk e kanë merituar të jenë veteranë luftëtarë.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jemi të qartë për këtë
16 pikë, ata që nuk kanë qenë në Kosovë dhe që nuk kanë qenë
17 anëtarë të UÇK-së, dhe që kanë marrë në -- pjesë në konferenca
18 diplomatike, për shembull. Sepse ju po iu drejtoheni këtyre
19 personave tani. Ju thoni që këta persona, pra ju këtu nuk e
20 keni fjalën për këta persona, më falni. E keni vetëm për FARK-
21 istët, kështu? Vetëm për anëtarët e FARK-ut, kështu?

22 PË. Po, zotëri Gjykatës, e kam fjalën vetë për anëtarët e
23 FARK-ut. Sepse qëndronin në ato pozicione në Tiranë me
24 fodullëk, duke shikuar nëpër ekranet televizive se si vritej
25 populli, se si vriteshin ushtarët, si vriteshin fëmijët, dhe

1 rrinin duarkryq nga atje. Edhe atëherë, edhe sot, prapë e
2 mendoj se ata nuk e meritojnë të jenë veteranë luftëtarë.
3 Sepse s'kanë qenë në luftë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po këtë e keni diskutuar me
5 ish-anëtarë të UÇK-së, qoftë gjatë luftës, apo edhe pas
6 luftës?

7 PË. Shumë herë e kam diskutuar me shokë e me ata. Gjithmonë
8 mendimi im ka qenë ky, kurrë s'kam qenë -- ndërruar qëndrim.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ky është thjesht qëndrimi
10 juaj, besimi juaj apo këtë e ndanit edhe me kolegë të tjerë,
11 shokë të tjerë, ish-anëtarë të UÇK-së? Pra, edhe këta persona
12 besonin që ata që kanë qenë anëtarë të FARK-ut dhe që nuk kanë
13 luftuar në Kosovë po që kanë qëndruar në Shqipëri, pra sipas
14 edhe këtyre personave, ata nuk e meritojnë statusin e
15 veteranit, apo vetëm qëndrimi juaj ky?

16 PË. Së pari, është qëndrimi imi, mirëpo e di, në bazë të
17 bisedave që kisha me shokët, e di që shumë njerëz mendojnë si
18 unë. Pavarësisht që nuk e thonë, disa ruhen disa s'kanë
19 dëshirë të flasin hapur, por qëndrime si unë ka shumë në
20 Kosovë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Qadraku, po në paragrafin
22 44 thuhet se keni përmendur edhe kërkesën e LDK-së -- për të
23 bërë kërkesën e përhershme të LDK-së për të hyrë në
24 marrëveshje me Milosheviçin dhe Milutinoviçin për t'i dhënë
25 Kosovës autonomi. Po kjo nuk përmbushte aspiratën tuaj dhe të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 60

1 të tjerëve, si dhe synimin për Kosovën dhe kjo nuk ishte një
2 marrëveshje e favorshme për Kosovën, dhe nuk ishte më e mirë e
3 marrëveshja e 23 marsit e vitit 1989.

4 Fillimisht, a ju kujtohet që ja keni thënë Prokurorisë,
5 dhe nëse po, a mund të na e shpjegoni çfarë keni dashur të
6 thoni ju me këto fjalë?

7 PË. Po, zotëri Gjykatës, më kujtohet. Me këtë -- me ato fjalë
8 unë kam dashur të them kështu: se Serbia okupatore e Kosovës
9 me 23 mars e vitit 1989 ja suprimon autonominë. Autonomia e
10 atëhershme ishte me lidhje federative. Dhjetë vjet pas asaj,
11 kryetari ynë historik bën një marrëveshje me Milutinoviçin dhe
12 pastaj edhe me Milosheviçin për një autonomi tjetër, autonomi
13 kjo që nuk ishte më në bazë federative, sepse Jugosllavia u
14 shpërbë, por kishte bazë vetëm Serbinë mbi të.

15 Kjo autonomi ishte për mua mbi 50 herë ndoshta më e vogël
16 se ajo autonomia që na u suprimua në vitin 1989. Prandaj,
17 mendoj, kam menduar, edhe sot mendoj, edhe do të jem i tillë
18 deri sa të -- deri në vdekje, se ajo marrëveshje ka qenë shumë
19 qëllimkeqe dhe dashakeqe. Ajo marrëveshje ka qenë shumë
20 poshtëruese për popullin tonë, për ato viktimat tona që kishim
21 deri në atë kohë, kur ajo e ka bërë, se marrëveshje është bërë
22 më 1 maj të vitit 1999. Ne atë kohë kishim mbi 13 mijë
23 viktima, kishim mbi 20 mijë gra të dhunuara, dhe kështu që
24 ndoshta atëherë kam menduar në afekt, sot e mendoj ndoshta tre
25 herë më fuqishëm të njëjtën gjë. Mendimi im personal.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Qadraku, ju
2 kur them ju, UÇK-ja dhe bashkëluftëtarët tuaj, keni luftuar
3 për autonomi të plotë, apo jo, për pavarësi të plotë, kështu?
4 PË. Betimi jonë si ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka
5 qenë për çlirimin e Kosovës. Për çlirimin e Kosovës, shtet i
6 pavarur dhe sovran të cilën në vitin 2008 e shpallëm, falë
7 udhëheqjes tonë politike.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Që të jem i qartë për këtë,
9 pra doni të thoni që nga pikëpamja juaj, duke kërkuar të hyjë
10 në marrëveshje me Milosheviçin dhe Milutinoviçin e Serbisë, me
11 qeverinë serbe, kjo do të thoshte se në këtë rast LDK-ja, ose
12 të paktën përfaqësuesit e LDK-së po dëmtonin betejën tuaj. Pra
13 po dëmtonin betejën dhe përpjekjet e UÇK-së për çlirimin e
14 Kosovës, duke bërë marrëveshje me këtë qeveri?

15 PË. Jo, zotëri. Është gabim. Nuk mendoj se LDK-ja ka gishtë
16 këtu. Kurrë nuk ka mbajtur LDK-ja një tubim, një mbledhje të
17 partisë, që të vendosë apo ta autorizojë kryetarin e tyre
18 historik që ta bëjë marrëveshjen me Milosheviçin apo
19 Milutinoviçin. Marrëveshja e tij me Milosheviçin është bërë,
20 mendoj, se s'kam lexuar ndonjë konsultim paraprak të tij me
21 dikë, këtu nuk fajësoj partinë LDK-në, sepse mbaj mend se edhe
22 kur ka bërë atë marrëveshje, nga Shkupi janë lajmëruar 212
23 intelektualë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilët
24 deklaruan se nga sot nuk njohin nënshkrimin e Ibrahim Rugovës,
25 çfarëdo që të vendosë ai në Beograd. Kështu që marrëveshje

1 Milosheviç-Rugova nuk ka qenë produkti i LDK-së. Ka qenë
2 produkt i tij personal.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur thoni me "produktin e
4 tij personal", kur thoni ai, e keni fjalën për z. Rugova? E
5 kuptova siç duhet?

6 PË. Po, e kam fjalën për Rugovën.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po për qeverinë e Bukoshit,
8 Qeverinë në Mërgim, a është pikëpamja jua që edhe ata kanë
9 punuar atëherë kundër interesave të UÇK-së dhe kundër
10 interesave të popullatës së Kosovës në atë kohë? Dhe në qoftë
11 se përgjigja është po, a e besoni ende këtë gjë?

12 PË. Bindja ime, z. Gjykatës, për qeverinë e atëhershme të
13 Kosovës, ata nuk kanë vepruar, dhe unë i akuzoj pse s'kanë
14 vepruar, e jo pse kanë vepruar. Por mosveprimi i tyre i ka
15 bërë vetvetiu të ata të jenë lojal, të jenë të poshtër, të
16 jenë vetëm spektatorë nga larg të të gjitha fatkeqësive që
17 kanë ndodhur në Kosovë. mos veprimi i tyre ishte i keq, e jo
18 vepra.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë prisnit ju prej tyre
20 që të bënin?

21 PË. Unë në atë kohë si një djalë i ri, si një djalos 34 vjet
22 i kisha atëherë, unë kam menduar se ata si qeveri nga viti
23 1992 deri në vitin 1998 do të ishte dashur të kontaktonin, të
24 punonin, të vepronin që të na siguronin mjetet e mundshme për
25 vazhdimin apo për luftimin e okupatorit. Ishin krijuar kinse

1 për një Kosovë republikë. Ata punonin kinse për një Kosovë
2 republikë. Mirëpo, kurrë nuk e quajtën Serbinë okupatore, e
3 sidomos pas 23 marsit të vitit 1989. Kurrë nuk kam lexuar në
4 programin e tyre që e cilësojnë Serbinë si okupatore. E
5 përderisa nuk e cilëson Serbinë si okupatore, ti nuk mund as
6 të veprosht kundër saj, sepse duhet çliruar. Në këto mendime
7 mendoj se ata kanë dështuar në përgjithësi, e me dështimet e
8 tyre na kanë dëmtuar si shtet, si popull, si ushtri, si rini,
9 si çdo gjë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A do prisnit ju prej
11 Qeverisë në Mërgim që të dërgonte para ose trupa, ose armë në
12 Kosovë që të luftohej kundër armikut?

13 PË. Kurrë z. Gjykatës, nuk kam prit nga ata para. Nuk kemi
14 pas nevojë për para. Kishim nevojë vetëm për armë, për
15 municion dhe asgjë tjetër. Para s'kishim as ku ta harxhonim,
16 mor zotëri.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po për ushtarë?

18 PË. Ushtarët i ka mbajti populli, nuk ka pas nevojë për paratë
19 e qeverisë fare. Secili fshat, secili vend, secila komunë na
20 kanë mbajti neve si pëllumbat na kanë mbajti. Populli neve na ka
21 mbajti para me të gjitha gjërat e nevojshme që kemi pas nevojë
22 gjatë luftës. E ata, ata, jo.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 45 të Shënimit
24 Përgatitor numër 2, ju flisni për z. Tahir Zemaj, i cili ka
25 qenë shkurtimisht si komandanti i zonës së Dukagjinit, dhe ju

1 thoni që z. Zemaj arriti që të bëhej komandanti zone, me Hara
2 -- kundër Haradinajt, me Haradinajn si zëvendës. Kur thoni
3 Haradinaj, këtu e keni fjalën për Ramush Haradinajn apo jo,
4 Dëshmitar? Është e saktë kjo?

5 PË. Po, zotëri Gjykatës, fjalën e kisha komandant Ramush
6 Haradinaj.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, komandant Ramush
8 Haradinajn si deputet. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk
9 lejoi që të ishte Zemaj komandant. Domethënë, Haradinaj ishte
10 si zëvendës i Zemajt. A është e saktë që ja keni thënë
11 Prokurorisë këtë?

12 PË. Po, zotëri, është e saktë. Domethënë, këtë informacion e
13 kam të lexuar pas luftës. Nuk e kam ditur këtë gjatë luftës,
14 por e kam thënë edhe mendoj se q'ashtu -- ashtu është.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju keni thënë që Shtabi i
16 Përgjithshëm nuk e ka lejuar Zemajn si komandant. A e dini se
17 çfarë ka bërë Shtabi i Përgjithshëm në këtë aspekt, në qoftë
18 se ka bërë ndonjë gjë? Pra, për të mos e lejuar Zemajn si
19 komandant. Ke lexuar ndonjë gjë lidhur me këtë ose ke dëgjuar
20 ndonjë gjë lidhur me këtë aspekt?

21 PË. Atë që unë e kam lexuar dhe për aq sa unë kam njohuri,
22 Shtabi i Përgjithshëm i ka reaguar sepse ai ka futur brenda
23 ushtrisë në Loxhe aty ku ishte që komandanti të zgjidhej me
24 votë, edhe në atë mënyrë ka arrit që të bëhet komandant e
25 Ramushi zëvendëskomandant. Unë mendoj se nëse ka qenë në këtë

1 bazë, reagimi i Shtabit të Përgjithshëm që mos të lejohen këto
2 forma të zgjedhjes së komandës, unë mendoj se kanë bërë të
3 drejtë, por prapë ju them se këto kanë qenë të gjitha të
4 lexuara pas luftës dhe mund të jem -- mund të mos jenë kështu.
5 Kam lexuar -- kaq.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Çfarë ka bërë konkretisht,
7 ose ekzaktësisht Shtabi i Përgjithshëm ose me fjalë të tjera,
8 çfarë reagimi ka pasur Shtabi i Përgjithshëm në lidhje me
9 këtë?

10 PË. Unë nuk e di çfarë ka reaguuar saktësisht. E di që kanë
11 shkuar atje dhe janë marrë vesh dhe janë kthyer. Më duket se
12 është kthyer prapë siç ka qenë, Ramush Haradinaj komandant,
13 Tahir Zemaj zëvendëskomandant. Por se si, dhe çfarë ka ndodhur
14 aty brenda midis atyre, unë s'e kam atë njohuri.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për të qenë të qartë, lidhur
16 me këtë pikë ju thatë që "ata u pajtuan". A po thoni që z.
17 Haradinaj, z. Zemaj dhe kushdo tjetër që mund të ketë shkuar
18 atje nga Shtabi i Përgjithshëm u pajtuan që z. Zemaj të
19 zëvendësohej nga z. Haradinaj dhe që z. Haradinaj më pas u
20 rivendos si komandant i zonës së Dukagjinit? Këtë po thoni?

21 PË. Po, ashtu se ashtu edhe ka ndodhur. Deri në fund të
22 luftës Ramush Haradinaj ishte komandant mandej.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, nga sa dini ju, dhe
24 pranohej që ju thatë që ju thatë që thjesht keni lexuar lidhur
25 me këtë, pra me sa dini ju ka pas një marrëveshje të paktën

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 66

1 midis tre palëve. Domethënë, midis z. Zemaj, z. Haradinaj dhe
2 Shtabit të Përgjithshëm. Këtë po thoni? Këtë keni lexuar? Këtë
3 keni dëgjuar?

4 PË. Po, besoj se ashtu është.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të
6 kalojmë në një temë tjetër. Besoj që nuk do të na duhet shumë
7 kohë lidhur me këtë. Në paragrafin 51 të Shënimit Përgatitor
8 numër 2 ,ju përmendni kontekstin e Ismet Tarës, pra,
9 inspektori i përgjithshëm i UÇK-së. Së pari dua t'iu pyes, a e
10 dini se kush ka qenë inspektori i përgjithshëm i UÇK-së në
11 vitin 1998 dhe në vitin 1999, në qoftë se ka pasur ndonjë
12 post, ndonjë pozicion të tillë?

13 PË. Unë mbaj mend se -- më kujtohet që kam dëgjuar se prej
14 inspektorëve të përgjithshëm kanë qenë z. Rexhep Selimi. Kurrë
15 nuk kam kontaktuar në këtë drejtim apo nuk mendoj a ka qenë
16 post apo vetëm ne ashtu e kemi quajtur, por kujtoj se në këtë
17 emërim, inspektori i përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm të
18 UÇK-së, mendoj që ka qenë Rexhep Selimi.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se kur u bë
20 inspektor i përgjithshëm z. Selimmi? A keni ndonjë informacion
21 lidhur me këtë?

22 PË. Jo, zotëri, nuk e kam këtë informacion. Për asnjërin
23 anëtar nuk e kam ndonjë informacion nga ku, nga cila datë ka
24 filluar të jetë ku, diçka. As nuk kanë njohur edhe kur janë
25 ndërruar njerëzit, edhe kur janë asi. Kështu që me datat e

1 emërimeve të tyre, ne kurrë nuk jemi njoftuar, as nuk kemi
2 pasur njoftime në zona, as nuk kemi pasur njoftime në njësitë
3 tona ku ishim në vitin 1998. Nuk kemi pas diçka të dokumentuar
4 për datën e fillimit, datën e emërimit të secilit njeri të
5 Shtabit të Përgjithshëm.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk e dini edhe
7 mënyrën se si z. Selimi u bë inspektor i përgjithshëm, kështu?
8 Në qoftë se kjo ka ndodhur në të vërtetë, domethënë, sepse ju
9 thatë që s'keni informacion. Pra nuk keni informacion të dorës
10 së parë lidhur me këtë, kështu?

11 PË. Po. Zotëri Gjykatës, unë nuk kam informacion të dorës së
12 parë, as nuk kemi marrë kurrë ndonjë njoftim për emërimin e
13 tij. Ne si zonë në -- zona e Pashtrikut.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të
15 kalojmë në një temë tjetër. Dëshiroj të flasim shkurtimisht
16 ose të diskutoj me juve shkurtimisht lidhur me atë çfarë ka
17 ndodhur, me sa dini ju, në Prizren. E kam fjalën për
18 paragrafin 57 dhe vijues të Shënimit Përgatitor numër 2. E
19 diskutuam këtë, e përmendi gjithashtu, z. Qadraku, që ju e
20 dini që komanda e zonës, Zona Operacionale e Pashtrikut ka
21 qenë e stacionuar ose e vendosur në konviktin e vajzave në
22 Prizren. Ajo çfarë thuhet në këtë paragraf të shënimit
23 përgatitor është që ju keni pasur një zyrë atje, por keni
24 thënë gjithashtu që ju gjithmonë keni fjetur në Rahovec. A
25 është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po, zotëri Gjykatës, është e saktë.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më tej, sipas paragrafit 57,
3 në seancën përgatitore, ju thoni se nuk e keni vizituar
4 shkollën për shurdhmemecët në Prizreni në qershor dhe në
5 korrik të vitit 1999. Nëse nuk e kam gabim, ju këtë e keni
6 përmendur ose e keni konfirmuar edhe të hënën gjatë pyetjeve
7 që ju bëri Prokurori, por, se ju besonit që Brigada 125 ka
8 qenë e vendosur në shkollën e shurdhmemecëve, ndërkohë që
9 Brigada 128 e kishte bazën në Zym të Dragashit, ose në Nashec,
10 të cilat të dyja kanë qenë në afërsi të Prizrenit. A është e
11 saktë kjo? A ja keni thënë Prokurorisë këtë, Dëshmitar?

12 PË. Po, zotëri Gjykatës. Kërkoj falje, se unë ndoshta me
13 vonesë po flas, por me sugjerim të Gjykatës po pres pesë
14 sekondshin e përkthyesëve.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk është fare problem, edhe
16 unë ndoshta duhet që të numëroj pesë sekondëshin. E kam bërë
17 më përpara por jo tani.

18 Gjithsesi, ajo çfarë dua të bëj tani është që t'iu jap
19 referencën për transkriptimin. Tre -- referenca e
20 transkriptimit është në faqet 22630 dhe 22631 të
21 transkriptimit tonë.

22 z. Qadraku, a e dini ose a keni ndonjë njohuri lidhur me
23 atë se çfarë ka ndodhur në ish ndërtesën e MUP-it në Prizren
24 në periudhën nga 16 deri më 18 qershor të vitit 1999?

25 PË. Jo, zotëri Gjykatës, unë nuk e di çfarë ka ndodhu aty, as

1 nuk e di çfarë ka ndodh në Prizren, sepse isha në Rahovec dhe
2 rrethinën e Rahovecit, deri në korrik të vitit 1999.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë, ju nuk keni qenë
4 asnjëherë personalisht atje? Pra keni qëndruar në Rahovec në
5 atë kohë, nuk keni qenë vetë aty, deri më 1 ose më 2 korrik të
6 vitit 1999. Kështu i takon?

7 PË. Po, zotëri Gjykatës, ashtu është.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dëgjuar ndonjë gjë
9 lidhur me një takim me KFOR-in gjerman në ish ndërtesën e MUP-
10 it, pas tërheqjes të forcave serbe? Keni dëgjuar ndonjë gjë
11 lidhur me këtë, Dëshmitar?

12 PË. Nuk di për saktësisht për çfarë takimi po jeni të
13 interesuar, por kemi parë në TV reagimin apo vrasjen nga KFOR-
14 i gjerman i një apo dy serbëve me një makinë. Kam parë diçka
15 të tillë, por për çfarë takimi specifikisht nuk po e kuptoj.
16 Ndoshta mund të sqarohemi.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do ta sqarojmë. Për të qenë
18 më konkret, a jeni në dijeni, ose a e dini në qoftë se ka
19 pasur persona që janë mbajtur dhe janë keqtrajtuar në
20 ndërtesën e ish MUP-it, pas tërheqjes së forcave serbe, në mes
21 të qershorit të vitit 1999?

22 PË. Jo, zotëri, nuk e di.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A keni dëgjuar ndonjë gjë
24 për një person të vjetër në moshë, i cili është gjetur i
25 vdekur, i lidhur në një karrige në një ndër katet e sipërme të

1 ndërtësës? Keni dëgjuar ndonjë gjë lidhur me këtë?

2 PË. Jo, zotëri.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni të krimeve
4 të tjera që pretendohet që të jenë kryer nga anëtarë të UÇK-së
5 në ditët pas marrjes së kontrollit në Prizren në verën e vitit
6 1999?

7 PË. Jo, zotëri, nuk më kujtohet diçka.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Megjithatë, ju keni qenë
9 ende shef i ZKZ-së, ose G2-shit në Zonën Operative të
10 Pashtrikut në atë kohë dhe unë mendoj që Prizreni është -- ka
11 qenë pjesë e zonës operative ku ju keni funksionuar apo jo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Po, zotëri Gjykatës, normalisht me të gjitha emërimet unë
14 kam qenë përgjegjës për të gjithë Zonën Operative të
15 Pashtrikut, por unë kam pasur vartësit e mi, unë kanë -- në të
16 gjitha dokumentacionet e mia nuk kam pasur këto, këso lloj
17 informatash nga S2-shi i Brigadës 125 apo 124 apo 128.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju nuk keni dëgjuar asgjë
19 lidhur me këtë, nuk është se keni parë asgjë as në televizion?
20 Asgjë? Nuk jeni i informuar nga burime të tjera, me fjalë të
21 tjera, domethënë, lidhur me atë çfarë pretendohet të ketë
22 ndodhur atje?

23 PË. Zotëri Gjykatës, kur kam shkuar unë në Prizren, i kam
24 propozuar komandant Tahir Sinanit që të takohemi sa më shpesh
25 me KFOR-in dhe me UNMIK-un. Kemi pas tre herë në javë me

1 policinë e UNMIK-ut takime, një herë në javë me KFOR-in e
2 brigadës shumëkombëshe të jugut. Në ato takimet tona ndoshta
3 janë cekur edhe këto, si kërkesë, si kërkesë e jona apo e
4 policisë së UNMIK-ut dhe të gjitha edhe këto raste, zotëri
5 Gjykatës, i kam pasur të evidencuara në takimet e UNMIK-ut, i
6 kam pasur të shkruara. Por në atë kohë kur jam arrestuar, të
7 gjitha ato dokumente dikush m'i ka shkatërruar, ose m'i ka
8 ndaluar. Kështu që sot, nga sot, ne -- unë s'di çfarë të flas,
9 as nuk di çfarë të kujtoj në këto, sepse këto janë çështje
10 shumë delikate për të cilat vetëm me kujtesë nuk guxoj t'i jap
11 vetes të drejtë që të flas për këtu. I kisha fakte, kisha
12 fakte, kisha letra, kisha ankesa, kisha hetime ndoshta për
13 këtë drejtim me të cilin e kam ndihmuar edhe UNMIK-un, edhe
14 FKOR-in në zbulimin e këtyre rasteve, por ato dokumente mua më
15 janë plaçkitur nga policia e UNIK-ut.

16 Prandaj ju thashë edhe ditën e parë, unë ndjehem sot
17 handikap para jush, sepse mund vetëm të flas. Kurse t'i kisha
18 ato dokumente, sot do t'iu ki -- do ta kishim dokumentuar
19 shumë më qartë, shumë më mirë edhe atë kohë të pas luftës në
20 Prizren e çdo kund.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. E kuptojmë.

22 Pyetja ime e fundit për ju, z. Qadraku, është kjo: Ju na
23 thatë dje gjatë pyetjeve që ju bëri Mbrojtja e z. Veseli, se
24 Kadri Veseli u bë shef i SHIK-ut në prill të vitit 1999, dhe
25 se SHIK-u merrej me zbulimin civil ose me shërbimin informativ

1 civil, ndërkohë që ZKZ-ja, ose G2-shi, merrej me shërbimin
2 informativ ushtarak. A është e saktë kjo, ju kujtohet ta keni
3 thënë këtë dje, Dëshmitar?

4 PË. Po, zotëri Gjykatës, ka qenë edhe në media. Vetë formimi
5 i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës më 2 prill të vitit 1999,
6 është dhënë cili lajm shumë i pritur që u formu qeveria,
7 kishim një qeveri të përkohshme, kishim një kryeministër,
8 kishim ministrat e tjera, dhe në mesin e tyre, ishte Kadri
9 Veseli, shefi i drejtorisë të shërbimit informativ.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përderisa ju keni - jeni
11 marrë me shërbimin e zbulim-kundërzbulimit, a mund të na
12 shpjegoni se çfarë detyrash kishte shërbimi informativ civil
13 në krahasim me shërbimin informativ ushtarak, ose shërbimin e
14 zbulim-kundërzbulimit? Ose me fjalë të tjera, çfarë
15 përgjegjësish kishte z. Veseli në atë kohë në departamentin e
16 vet ose në institucionin ku punonte?

17 PË. Nuk mund të jap, nuk di, se jo nuk mund ta jap. Nuk e di
18 se çfarë asojne. E di që në Kosovë ka pasur nga KFOR-i
19 amerikan, nga KFOR-i anglez, nga policia e UNMIK-ut e nga të
20 gjithë këta, e di një që kam lexuar që SHIK-u është legal,
21 SHIK-u bashkëpunon me të gjitha strukturat ndërkombëtare që
22 ishin prezentë në Kosovë. E di, domethënë q'ato -- këto
23 njohuri i kam, por çfarë, në pyetjen e juaj se çfarë detyrash
24 specifike kishte SHIK-u, këto mund vetëm t'i hamendësojmë, që
25 nuk besoj se hamendja ime apo mund t'iu hyjë në punë juve.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë kjo varet, në fakt,
2 kështu që do ju bëj një pyetje tjetër plotësuese. Thatë më
3 herët që G2-shi dhe ju vetë në pozitën që kishit si shefi i
4 G2-shit në nivel zone, jeni marrë me zbulim ushtarak, pra jeni
5 marrë me shërbimin informativ ushtarak, me fjalë të tjera. Për
6 shembull, keni mbledhur informacion që kishte të bënte me
7 pozicionin e forcave serbe, sa të forta ishin këto forca, me
8 armët që kishin ata në dispozicion. A do ishte e drejtë që të
9 prezumohet ose të supozohet që kjo gjithashtu ishte pjesë e
10 përgjegjësisë së SHIK-ut apo ishte një çështje që në fakt
11 trajtohej nga Shërbimi Informativ Ushtarak, ose G2-shi?
12 PË. Këto që ju përmendët, këto trajtoheshin nga G2-shi, apo
13 departamenti informativ, apo shërbimi ushtarak i G2-shit.
14 Kurse për shërbimin civil vërtetë nuk kam njohuri sepse s'kam
15 qenë kurrë pjesë e saj. Tani në këtë aspekt unë kam mendu se
16 jam pjesë e SHIK-ut. Ju kam shpjeguar, e kam shkruar edhe
17 vetë, shefi i SHIK-ut, e kam shkruar shefi i G2-shit, e kam
18 shkruar shefi i ZKZ-së, e kam shkruar shefi i departamentit
19 informativ, atëherë kur kam menduar se jam shefi i të gjitha
20 këtyre akronimeve, duke menduar se janë një. Mirëpo pas
21 luftës, pas luftës vërtetë nuk kam kurrfarë njohurish të punës
22 së shërbimit informativ kombëtar, përpos veç zyrën e G2-shit
23 apo ZKZ-së.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk keni pas interes
25 që të mësonit ose të dini se çfarë bënte SHIK-u përderisa dhe

1 ju vetë merreshit me shërbimin e zbulim-kundërzbulimit?

2 PË. Unë kam pas shumë interes, zotëri Gjykatës, por unë e di
3 që kanë qenë njerëz të besuar aty, dhe nuk kam pas nevojë me
4 besu apo me shku me i kontrollu çfarë po bëjnë. Nuk kam -- kaq
5 domethënë, këta kanë pas detyrën e vet, unë kisha detyrën
6 time, jam mundu me atë timen detyrën time ta kryej me nder,
7 edhe pse nuk isha profesionit në këtë drejtim, por kaq di me
8 thënë për momentin.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ke pyetur asnjëherë
10 askënd lidhur me këtë, domethënë lidhur me punët, me
11 përgjegjësitë e SHIK-ut, çfarë bënte SHIK-u? S'keni pyetur
12 asnjëherë?

13 PË. Po, nuk e kam pyetur në këtë mënyrë siç po pretendoni ju,
14 t'i them se "çfarë po bëni", e din? Por "Si po kaloni? A jeni
15 mirë? A po lodheni, a keni nevojë ndonjë ndihmë me ju dhënë".
16 Ndoshta si shokë, kaq kam mujt me ju thanë atyne, por jo çfarë
17 po punoni, se nuk është etike ajo tashti, për mua.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, z. Qadraku.
19 Nuk kam pyetje të tjera për.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
21 z. Qadraku, tani do bëjmë pushimin e drekës. Mund të largoheni
22 nga salla së bashku me Asistenten. Ju lutem mos flisni me
23 askënd jashtë sallës së gjyqit lidhur me dëshminë tuaj. Do
24 shihemi përsëri këtu në orën 14.30, z. Qadraku.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zoti

2 Sekretar, ju lutem na kaloni në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi
16 në seancë të hapur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
18 z. Sekretar, do bëjmë pushim deri në orën 14.30.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

20 --- Seanca rifillon në orën 14.30

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
22 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
25 tani e ka radhën Gjykatësi Mettraux, që është ulur në të

1 djathtën time, në të majtën tuaj, dhe ai do t'ju bëjë disa
2 pyetje.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.

4 PË. Mirëdita, z. Gjykatës.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë do të doja të filloja
6 me disa pyetje që lidhen me periudhën që keni qëndruar në
7 Zvicër, që janë pyetje plotësuese që ju janë bërë tashmë nga
8 palët.

9 Për të qenë i sigurt për kronologjinë kohore, thatë që
10 keni shkuar në Zvicër në 1987, të paktën siç e kuptova unë,
11 dhe jeni larguar nga Zvicra më 11 mars 1998, kështu?

12 PË. Po, z. Gjykatës.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju na shpjeguat që kur
14 keni qëndruar në Zvicër keni qenë veprimtar në LPK dhe se keni
15 marrë pjesë në disa mbledhje të organizuara nga LPK-ja,
16 kështu?

17 PË. Po, z. Gjykatës.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani unë fillimisht dua
19 t'ju pyes lidhur me këtë. Këto mbledhjet që keni pasur ju me
20 anëtarët e tjerë të LPK-së në Zvicër, këto mbledhje janë bërë
21 fshehurazi, privatisht dhe në mënyrë klandestine?

22 PË. Jo, z. Gjykatës. Në Zvicër mbledhjet ne i kemi ba
23 legalisht. Ne nuk kemi pas nga kush të fshifemi në Zvicër.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk po them që bënit diçka
25 të jashtëligjshme, mos më keqkuptoni. Por përveç mbledhjeve

1 publike, a keni pasur edhe diskutime, mbledhje, por më
2 privatisht, keni pasur?
3 PË. Z. Gjykatës, unë ku kam vepruar, në Lozanë, kemi qenë 32
4 anëtarë të LPK-së. Kaq, kurrë ma shumë nuk kemi pas. Mirëpo
5 ato 32 anëtarë kemi, mendoj që jemi takuar çdo dy javë për të
6 diskutuar për situatën politike në Kosovë, për mundësitë tona
7 çfarë mund të ndihmojmë nga Zvicra që të propagandojmë për
8 okupimin ose për çlirimin. Kishim mbledhje të zakonshme,
9 biseda të zakonshme, ndonjëherë kishim pjesë kulturore,
10 ndonjëherë kishim protesta para ambasadave jugosllave,
11 ndonjëherë kishim protesta para Kombeve të Bashkuara në
12 Gjenevë. Për këto gjëra, domethënë, ne gjithmonë kemi
13 diskutuar duke munduar që ta propagandojmë okupimin klasik që
14 ishte në Kosovë, i instaluar nga viti 1945.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'jua shpjegoj arsyen
16 pse po jua bëj këtë pyetje. Unë po ju pyes nëse keni pasur
17 shqetësime ju gjatë kohës në Zvicër kur merrnit pjesë në
18 veprimtaritë e LPK-së, a kishit merak apo ndonjë shqetësim se
19 mund të kishte të infiltruar serbë në kohën që keni qenë ju në
20 Zvicër, a ka qenë ky një shqetësim që mund të kishte të
21 infiltruar, apo përpjekje nga Serbia për të infiltruar persona
22 në LPK?

23 PË. Unë mendoj se Lëvizja Popullore e Kosovës ka pas kujdes
24 në këtë drejtim. Ka pas një kriter që me e njoft mirë personin
25 para se të pranohet. Ka pas një kriter që ta dijë historikun e

1 tij familjar, historikun e tij veprimtar. Nuk di ndonjë rast
2 konkret të ketë ndodhur ashtu si për çfarë flisni ju, mirëpo
3 mendoj, mendoj se dikush më i madh se unë, dikush më i lartë
4 se unë ka menduar edhe për këtë, edhe për këtë rast.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përveç verifikimit të së
6 shkuarës së familjarëve të anëtarëve, kaq, me sa keni ju
7 dijeni është marrë ndonjë masë tjetër në LPK për të
8 parandaluar, për të parandaluar pikërisht infiltrime të tilla?
9 PË. Jo, z. Gjykatës, nuk di për masa të tjera.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flas sërish për këtë
11 pas një çasti. Por fillimisht, a mund të na tregoni si ishte
12 organizuar LPK-ja në Zvicër vitet, pra vitet që i kanë
13 paraprirë konfliktit, para konfliktit?

14 PË. Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar, mund të flas
15 më shumë se isha edhe vetë atje. Ne, ju thashë edhe pak më
16 parë, kemi qenë të organizuar në secilin kanton, mundësisht sa
17 më shumë të kishim simpatizantë edhe anëtarë. Vazhdimisht
18 kemi, jemi konsultuar, jemi, kemi kërkuar shtigje për të dalë
19 nga kjo, nga kjo situatë që ishte në Kosovë. Ne kemi paguar
20 anëtarësi, anëtarësi si anëtarë të lëvizjes popullore. Kishim
21 një shumë simbolike të vogël, paguanim edhe pak për anëtarët
22 që i kishim brenda vendit, në Kosovë, të cilët nuk kishin
23 mundësi ekonomike. Kishim edhe një pjesë për ata të paguanim.
24 Domethënë, fillimisht kështu ka filluar kjo.

25 Mandej, mbaj mend që pak më vonë u formua edhe fondi

1 "Vendlindja Thërret", i cili ishte ma shumë i dedikuar për
2 armatimet e grupeve të armatosura që vepronin në Kosovë. Ne
3 përmes tyre mundoheshim që t'i ndihmonim ata sepse ata atë
4 mundësi nuk e kishin. Unë personalisht nuk kam shkuar përtej
5 Lozanës, përtej këshillit tim ku isha unë, mirëpo mendoj se
6 shokët nga këshilli i përgjithshëm edhe nga kryesia e LPK-së e
7 kanë pas detyrën që t'i çojnë këto amanete apo këto vendime që
8 janë marrë në përmbledhjet e këshillave të rrethit, që atëherë
9 u quashin, deri në, deri në ekzekutimin e atyre vendimeve.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nga pikëpamja
11 gjeografike, dhe më thoni nëse e kam gabim, ka pasur një
12 ndarje pra të territorit zviceran në zona gjeografike, në
13 qarqe gjeografike, dhe brenda një zone gjeografike, pra secila
14 zonë gjeografike kishte një këshill përgjegjës për atë zonë. E
15 kam kuptuar drejt?

16 PË. Po, z. Gjykatës.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jam ende në periudhën
18 kohore kur keni qëndruar në Zvicër dhe për një çast do ju pyes
19 për Lozanën. Disa prej anëtarëve të LPK-së me të cilët keni
20 pasur kontakte, më pas u bënë anëtarë të UÇK-së dhe u bënë
21 pjesë e luftës në Kosovë, e drejtë?

22 PË. Po, z. Gjykatës.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na tregoni kush
24 person e ka bërë këtë, kush ju kujtohet ju të paktën? Nga ata
25 që keni pasur në LPK në Zvicër, cili prej tyre u bë pjesë e

1 luftës për UÇK-në? Ju kujtohet?

2 PË. Po, z. Gjykatës. Më kujtohet. Nga këshilli i rrethit të
3 Lozanës kemi shkuar në luftë Ismet Jashari, Kumanova, që vinte
4 nga rrethi i Kumanovës, ka qenë Haxhi Shala, Topi, që ishte
5 nga Banja e Malishevës, isha unë dhe gjatë dy viteve të fundit
6 1997 edhe janar, shkurt 1998, e kishim të ardhur edhe Fatmir
7 Limën i cili qëndronte aty, pra, në Lozanë. Kështu që, ne
8 jemi, unë këta katër njof, që kemi ardhur nga, që kemi shkuar
9 nga Zvicra në Kosovë për të luftuar.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. A mund të na
11 konfirmoni nëse Haxhi Shala ka qenë i afërm, kushëri i Fatmir
12 Limës?

13 PË. Unë nuk e di për afërsinë familjare, por e di që vijnë nga
14 një fshat. Nga fshati Banjë e Malishevës vijnë po të dy.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Xhavit Haliti, a ka
16 qenë dhe ai një nga personat që ka qëndruar në Zvicër dhe u bë
17 pjesë e luftës për UÇK-në?

18 PË. Po, z. Gjykatës. Xhavit Haliti ka qenë në këshillin e
19 rrethit të Cyrihut. Ishte pjesë edhe e këshillit të
20 përgjithshëm, edhe e kryesisë, por mendoj se ka qenë edhe
21 anëtar i LPK-së, edhe pjesëmarrës në luftë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Emrush Xhemajli, edhe
23 ai? Të cilin ju e njihni, apo jo?

24 PË. Po, z. Gjykatës, edhe ai.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të them

1 që Emrush Xhemajli është një person që ka dhënë kontribut të
2 madh fillimisht për LPK-në, dhe më pas për UÇK-në. Pajtoheni
3 me propozimin tim?

4 PË. Po, z. Gjykatës, pajtohem. Emrush Xhemajli me komplet
5 familjen e tij ka dhanë një kontribut të madh në organizimin,
6 në veprimtarinë edhe në luftën për çlirimin e Kosovës.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e dini, sigurisht, a
8 mund të na e konfirmoni dot nëse ka punuar ai për një periudhë
9 kohore për Zërin e Kosovës, por në Zvicër?

10 PË. Z. Gjykatës, gjatë qëndrimit tim në Zvicër unë e di se
11 Zëri i Kosovës e kishte selinë në Biel, që ishte kantoni
12 ndoshta i Bernit. Nuk -- besoj që ashtu. Edhe e di se ai ka
13 qenë njëri ndër përgjegjësit e gazetës me shumë shokë të
14 tjerë, me Destan Hajdinin, me Avni Deharin, me shumë shokë ka
15 qenë përgjegjës i gazetës Zëri i Kosovës, që ishte organ i
16 Lëvizjes Popullore të Kosovës.

17 Deri në vitin 1992. E 1992 unë me shokët e Lozanës pasi që
18 nuk kishte qëndrueshmëri financiare, unë me shokët e Lozanës e
19 kemi marrë komplet -- kemi marrë, unë s'kam qenë aty mirëpo
20 edhe unë jam pjesë e asaj. E kemi transferue redaksinë e Zërit
21 të Kosovës në Lozanë. Pastaj në Lozanë ka vazhdu të botohet
22 deri në vitin, sa mbaj mend unë, 1995 apo 1996.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë kohës që keni
24 qëndruar në Zvicër, në Lozanë, afër liqenit jetonte dhe Sadik
25 Halitjaha, apo jo?

1 PË. Po, z. Gjykatës, Sadik Halitjaha ishte i stacionuar apo i
2 vendosur të jetonte në Sion [Fonetikisht]. Në Sion, kantoni i
3 Valais.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe mes z. Halitjaha dhe
5 mes jush, kontesë suaj, ka qenë z. Ramush Haradinaj dhe z.
6 Bardhyl Mahmuti, pra mes konteve tuaja, kanë qenë dhe z.
7 Ramush Haradinaj dhe Bardhyl Mahmuti, saktë?

8 PË. Z. Bardhyl Mahmuti ka qenë në kanton të Lozanës, që me
9 një fshat aty afër Vevey apo Aigle. Kurse Ramush Haradinaj nuk
10 e kam njohur, edhe nuk kam pasur dijeni ku jetonte, edhe ku
11 vepronte, ku punonte.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po Adem Grabovci dhe
13 Shukri Buja, i ke njohur gjatë kohës që ke qëndruar në Zvicër?

14 PË. Adem Grabovcin, z. Gjykatës, e kam njohur nga vitet 1990,
15 kur ishim në procesin e pajtimit të gjatë. Kurse Shukri
16 Bujën e kam njoftur në vitin 1998 gjatë luftës në një rrugëtim
17 nga Shqipëria për në Kosovë.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini ju se të dy këta
19 persona kanë qenë në Zvicër dhe kanë qenë të dy veprimtarë të
20 LPK-së asokohe?

21 PË. Po, zotëri, e di. Adem Grabovci ka qenë më duket në
22 kantonin e Sangallës [Fonetikisht], kurse për Shukri Bujën nuk
23 e di, por e dija vëllain e tij Agush Bujën që kisha më shumë
24 njohuri me të.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se e keni përmendur

1 një herë, por do t'jua kërkoj dhe një herë ta konfirmoni. Në
2 atë kohë, ka qenë i pranishëm në Zvicër dhe po ashtu veprimtar
3 i LPK-së Ali Ahmeti dhe Fazli Aliu -- Veliu, më falni, kështu?
4 PË. Po, z. Gjykatës. Edhe Ali Ahmeti, edhe Fazli Veliu kanë
5 qenë në Zvicër. Mendoj se kanë qenë në kantonin e Luzern-it.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe mbase Zug për këtë
7 fundit, më fundit --

8 PËRKTHYESI: Më falni, shqiptimi sipas Gjykatësit, Zug.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në intervistën që i keni
10 dhënë ZPS-së keni thënë të paktën sipas tekstit, është Pjesa
11 1, faqja 17, është tashmë pjesë e provave gjyqësore, me numër
12 P1854. Këtu thuhet që të gjithë anëtarët e LPK-së e dinin që
13 UÇK-ja po formohej. Flasim për vitet që keni qëndruar në
14 Zvicër. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

15 PË. Po, z. Gjykatës.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju personalisht dhe
17 veprimtarët e tjerë të LPK-së, përfshirë ata në Zvicër, jeni
18 përpjekur në thelb të krijoni një organ ushtarak për të
19 luftuar në Kosovë. Pajtoheni me propozimin tim?

20 PË. Normalisht do të isha shumë i kënaqur, por mendoj se jemi
21 përpjekur secili në ato treva ku kemi jetuar në Kosovë që t'i
22 zgjerojmë radhët dhe të organizojmë luftën çlirimtare.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sipas Shënimit Përgatitor
24 2, paragrafi 7, ju keni thënë që LPK-ja e ka krijuar apo e ka
25 themeluar UÇK-në, kështu?

1 PË. Z. Gjykatës, ndoshta është, mund të jem gabuar. Lëvizja
2 Popullore e Kosovës e ka bërë emërtimin që folëm pak më herët
3 më duket me Gjykatësin e nderuar, që ka ndodhur më 17 nëntor
4 1994. Mirëpo, e di simbas atyne që kam lexuar, LPK-ja ka
5 kontribuar në bashkimin e të gjitha atyne grupeve që vepronin
6 edhe luftonin edhe më herët se sa 1994. Mendoj se ka një
7 pozitivitet në atë veprim, një punë të mbarë që e ka kriju në
8 këtë punë. Por që është krijuese dhe formuese, ata veç shumë
9 kanë qenë edhe të krijuar edhe të formuar para se të emërohej
10 Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Kështu që për bashkimin e të
11 gjitha atyre në një embleme, mendoj që ka një rol shumë të
12 rëndësishëm Lëvizja Popullore e Kosovës.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë do t'ju lexoj atë që
14 është thënë këtu dhe më thoni nëse është nevoja ta
15 korrigjojmë. Është Shënimi Përgatitor numër 2, paragrafi 7.
16 Sipas kësaj ju keni thënë që:

17 "Mund ta kem thënë që kam qenë i përfshirë në krijimin e
18 UÇK-së, sepse kam qenë anëtar i LPK-së dhe LPK-ja krijoi ose
19 themeloi UÇK-në ..."

20 E pranoni ju këtë propozim, a është pasqyruar tamam
21 dëshmia juaj, apo keni nevojë që të korrigjohet kjo pjesë?

22 PË. Jo, zotëri, nuk kam nevojë të korrigjohem. Mendoj që e
23 pranoj kështu sepse edhe unë ashtu e thashë. E krijoi, por e
24 krijoi nga grupet që veç ishin prezentë edhe para se të
25 emërohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës, edhe me pjesëmarrjen

1 tonë natyrisht.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ashtu keni thënë në
3 paragrafin 9, që:

4 "Ideja e UÇK-së lindi nga LPK-ja."

5 Me sa keni ju dijeni, a është e saktë dhe e vërtetë kjo?

6 PË. Po, e diskutuam edhe pak ma parë. Domethënë, ideja për
7 emërimin edhe për bashkimin e krejt atyne grupeve në një
8 emblemë mendoj që ishte ideja e Lëvizjes Popullore të Kosovës.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas, sipas këtij
10 teksti, ju keni thënë që jeni kyçur në UÇK në 1994 sepse keni
11 qenë anëtar i LPK-së, pra shprehja që është përdorur këtu
12 është "automatikusht".

13 Pra ju keni dëgjuar që jeni bërë automatikusht anëtar i
14 UÇK-së. Më korrigjoni nëse e kam gabim, por duke qenë ju
15 anëtar i hershëm i UÇK-së në 1994, ju keni qenë atëherë një
16 nga personat që keni kontribuar për themelimin e UÇK-së prej
17 LPK-së? E pranoni këtë propozim?

18 PË. Po, z. Gjykatës. Mirëpo, mendimi im ka qenë kur e kemi
19 diskutuar edhe me Prokurorinë, se moralisht e kam ndier veten
20 pjesëtar i UÇK-së qysh nga ajo ditë kur është emëruar nga
21 Lëvizja Popullore e Kosovës, sepse unë vetëm kam pritur kur do
22 të më thërrasin, ose kam pritur kur do të jetë nevoja që nga
23 ai, ajo nga ajo datë, pra nga 1994 unë kam qenë i gatshëm çdo
24 moment, çdo ditë, që të shkoj në Kosovë të luftoj nëse më
25 kërkojnë, nëse më udhëzojnë shokët. Edhe kështu ka qenë secili

1 anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës në Zvicër në Gjermani,
2 në Itali, në Amerikë, kudo që ishim në mbarë botën.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim dhe për 17
4 nëntorin pas një çasti. Por fillimisht, a mund të na thoni
5 kush kanë qenë personat e tjerë që kanë ndihmuar për krijimin
6 apo organizimin e UÇK-së nga LPK-ja?

7 PË. Më vjen keq nga ata që i kam përmendur, që kanë qenë si
8 grup i veçantë për veprimet e veçanta. Unë nuk kam njohuri të
9 tjera, nuk jam aq mbrenda atyne, atyne veprimeve konkrete. Jam
10 pjesë e thjeshtë e LPK-së. Kaq.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do bëj një pyetje të
12 ndryshme.

13 I lutem Sekretarisë të nxjerrë në ekran dokumentin që
14 mban numrin 074625. Shqipja është me të njëjtin numër.

15 Po ju jap kontekstin fillimisht dhe pastaj e diskutojmë
16 bashkë. Ky është një dokument -- shkojmë në faqen e fundit, ju
17 lutem, në të dyja gjuhët. Faleminderit.

18 Sikurse mund ta shihni, ky është një dokument që është
19 përgatitur, hartuar nga Emrush Xhemajli, personi që përmendët
20 pak më përpara dhe një anëtar i rëndësishëm ky i LPK-së dhe i
21 UÇK-së. Dhe këtë dokument e ka përgatitur në shkurt të 2002,
22 në bazë të një vendimi, pra me vendimin e kryesisë së
23 këshillit të përgjithshëm të LPK-së.

24 Tani mund të shkojmë në faqen e parë.

25 Siç mund ta shihni, ky është një historik i shkurtër i

1 Lëvizjes Popullore të Kosovës. Është në ballinë kjo, "Viti
2 1982-2002, 20 vjet veprimtari".

3 Pyetja ime e parë është kjo, fillimisht a e keni parë
4 ndonjëherë më përpara dokumentin që kemi tani në ekran?
5 PË. Po, z. Gjykatës, e kam parë. Edhe pse ky, ky organ apo
6 kjo gazetë, kjo informatë është nxjerrë në vitin 2002, unë
7 atëherë kam qenë në burg. Por pas daljes time nga burgu në
8 mars të 2003, e kam lexuar edhe besoj që, nuk më kujtohet
9 ndoshta në tërësi secila fjalë, mirëpo e kam lexuar.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen 6, dhe
11 tek anglishtja edhe tek shqipja.

12 Ju lutem, fokusohuni tek pika që mban datat 1993 deri në
13 1995, ky paragraf. E gjetët?

14 PË. Po, zotëri.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë po jua lexoj dhe më
16 pas do t'ju bëj disa pyetje. Fillon kështu:

17 "Pjesë të këshillave të LPK-së në Skënderaj, Gllogoc,
18 (Drenas), Klinë, Ferizaj, Prishtinë, Podujevë (Besiana e
19 sotme), Suharekë (Therandë), Prizren, Rahovec, Malishevë,
20 Deçan, Gjakovë, Pejë, Gjilan, Kërçovë, Tetovë, Shkup,
21 Kumanovë, e cila më herët, e cila më vonë shndërrohen në njësi
22 të para të armatosura."

23 Pyetja ime e parë është kjo: A është e vërtetë që para
24 konfliktit, veçanërisht në fillim të viteve 1990, LPK-ja
25 kishte organizim dhe në Kosovë dhe në Maqedoni? Dhe në Kosovë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)
Prokurori nga Trupi Gjykses

Faqe 89

1 dhe në Maqedoni kishit këshilla lokalë të ngjashëm me ato që
2 kishit në Zvicër, siç e përshkruat ju, kështu?

3 PË. Po, mendoj se kështu është.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe më pas, me kalimin e
5 kohës, sipas dhe këtij dokumenti, disa prej këtyre këshillave
6 u kthyen në njësi të armatosura. Dhe gradualisht LPK-ja u
7 shndërrua në UÇK. A pajtoheni me mua?

8 PË. Po, z. Gjykatës, pajtohem. Secili anëtar i Lëvizjes
9 Popullore të Kosovës e ka menduar veten si luftëtar i Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas, dokumenti thotë:

12 "Veprimtarët më të njohur që nga puna politike iu
13 përkushtuan punës ushtarake ishin: Durmish Gashi, Halil
14 Qadraku, Selim Gashi, Xheladin Gashi, Sokol Bashota, Fatmir
15 Limaj, Ragip Shala, Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi, Isa
16 Krasniqi, Asllan Pantina, Skënder Rexhepi, Fadil Nimani,
17 Rexhep Bislimi, Qerim Kelmendi, Adrian Krasniqi, Gursel
18 Sylejmani, Beqir Limani, Xhemajl Jashari, Ismet Sylejmani,
19 Shaqir Shaqiri, Jonuz Musliu. etj."

20 A pajtoheni me këtë përshkrim këtu, në qoftë se e dini,
21 kuptohet, a kanë qenë këta persona vërtetë veprimtarë të
22 njohur që iu përkushtuan punës ushtarake, dhe nga puna
23 politike siç thuhet këtu iu përkushtuan punës ushtarake, në
24 këtë periudhë kohore? Pajtoheni me këtë përshkrim?

25 PË. Pajtohem që kemi qenë në shërbim.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju nuk është se keni
2 ndonjë problem këtu me asnjë prej emrave që citova, kështu?
3 PË. Jo, zotëri. 98 për qind, 99 për qind, 100 për qind i njof
4 të gjithë. Ose i kam njohur, kërkoj falje, se shumica janë të
5 vdekur ose të vrarë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në qoftë se është e -- në
7 qoftë se mundeni, dua që t'ju kërkoj që të lexoni pikën tjetër
8 në këtë dokument. Domethënë, paragrafin më poshtë atij që sapo
9 lexova. Ju lutem, lexojeni me vete, Dëshmitar.

10 Do e lexoj edhe për ata që nuk flasin shqip. Thuhet:

11 "17 nëntor 1994, Aarau, Zvicër. U lëshua komunikata e
12 parë ushtarake. Kryesia e LPK-së, pas insistimit të grupeve të
13 armatosura brenda vendit, merr vendim për fillimin e lëshimit
14 të komunikatave në të cilat merret përsipër autorësia e tyre.
15 Pas një diskutimi të premtuar, kryesia duke pasur parasysh
16 edhe propozimet e grupeve ushtarake në terren, mori vendim që
17 organizimi i ri ushtarak të quhet 'Ushtria Çlirimtare e
18 Kosovës'. Komunikata u vendos të mbajë numrin 11. Në këtë
19 mbledhje merrnin pjesë: Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Ali
20 Ahmeti, Xhavit Haliti dhe Gafurr Elshani".

21 A mund të konfirmoni, megjithëse kam përshtypjen që e
22 keni bërë këtë gjë, por a mund të konfirmoni që komunikata e
23 parë ushtarake e UÇK-së është lëshuar në këtë datë. Domethënë,
24 më datën 17 nëntor 1994? E konfirmoni këtë, Dëshmitar?

25 PË. Po, mendoj që po.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A pajtoheni që ky ka qenë
2 një rast i rëndësishëm për UÇK-në, a pajtoheni me këtë, që kjo
3 ka qenë një ngjarje e rëndësishme për UÇK-në?

4 PË. Z. Gjykatës, kjo mendoj që ka qenë një ngjarje e
5 rëndësishme në veçanti për UÇK-në, por në përgjithësi për të
6 gjithë Kosovën edhe për të gjithë popullin shqiptar.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sepse UÇK-ja po dilte me
8 emrin e vet, edhe me zërin e vet, a pajtoheni ju me këtë,
9 Dëshmitar?

10 PË. Po, sepse për herë të parë po dilte një formacion i
11 emëruar, jo ilegal, jo X personi, por dilte një formacion i
12 emëruar i organizuar që do të komunikonte me popullin përmes
13 komunikatave, kurse me armikun përmes pushkëve.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ne e shohim që kush z.
15 Xhemajli sugjeron që ka qenë i pranishëm në këtë takim më datë
16 17 nëntor 1994. Xhavit Haliti ka sugjeruar që autorët e kësaj
17 komunikate të parë kanë qenë ai vetë, domethënë, Xhavit
18 Haliti, Azem Sylja, Emrush Xhemajli dhe Ali Ahmeti. A keni
19 ndonjë arsye për të vënë në dyshim ose për të kontestuar këtë
20 sugjerim?

21 PË. Jo, z. Gjykatës, nuk kam arsye. Sepse të gjithë ishin ose
22 anëtarë kryesie, ose anëtarë të grupimit për veprimet e
23 veçanta. Domethënë kështu që të gjithë këta emra qëndrojnë
24 ashtu siç kanë shkruar.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Harrova t'jua bëja këtë

1 pyetje pak më përpara, po jua bëj tani. Kur jeni larguar nga
2 Zvicër më datë 11 mars të vitit 1998, me sa kuptova unë ju i
3 hipët avionit dhe shkuat në Tiranë, a ka ndodh kështu,
4 Dëshmitar?

5 PË. Jo, z. Gjykatës. Kam shkuar nga Cyrihu për në Prishtinë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me kë u larguat nga
7 Zvicra, keni qenë vetëm apo jeni larguar bashkë me ndonjë
8 pjesëtar tjetër të LPK-së, që është larguar bashkë me juve nga
9 Zvicra në këtë rast?

10 PË. Në këtë drejtim me aeroplan jam larguar vetëm, kurse
11 shokët e tjerë që e përmenda më herët ata kanë shkuar së pari
12 në Shqipëri, nga Shqipëria të hyjnë në këmbë në Kosovë. Unë
13 kam shkuar vetëm me aeroplan deri në Prishtinë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A do të thotë kjo që ata
15 kanë mbërritur pak pas teje apo kishin mbërritur në Kosovë kur
16 ti arrite në Kosovë?

17 PË. Zotëri, nuk e mendoj se ata kanë mbërritur para meje. Se
18 unë kam mbërritur për një orë e gjysmë, kurse ata besoj
19 minimum katër ditë kanë zgjat armatosja, përgatitja, hyrja e
20 tyre deri në Kosovë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Dua t'ju
22 pyes edhe për diçka tjetër të ndryshme. Dua ta sqaroj pak këtë
23 aspekt me ju. Është një temë për të cilën ju jeni pyetur dhe
24 të cilës i jeni përgjigjur gjatë intervistës me ZPS-në, në
25 Pjesën 1, faqja 9 në veçanti të provës që tanimë është pranuar

1 me numër P1854. Ju aty pyeteni nëse jeni, keni qenë i dënuar
2 më përpara. Dhe ju jepni shpjegimet përkatëse lidhur me këtë
3 çështje, ku ndërhyjnë edhe Avokati juaj, ku thotë që ka pasur
4 një hetim, ka pasur një aktakuzë, por që ju jeni deklaruar jo
5 fajtor dhe jeni liruar nga një gjykatë e UNMIK-ut. Pra jeni
6 deklaruar i pafajshëm dhe jeni liruar nga një gjykatë e
7 UNMIK-ut.

8 A ju kujtohet kjo pjesë, Dëshmitar? Ky diskutim, ju
9 kujtohet?

10 PË. Po, z. Gjykatës.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua ta sqarojmë pak këtë
12 çështje bashkë. Kjo lënda që përmendet këtu, që thuhet që ka
13 pasur hetim lidhur me këtë lëndën, dhe që është lëshuar një
14 aktakuzë, dhe që jeni liruar nga gjykata e UNMIK-ut, a mund të
15 na shpjegoni pak, për çfarë lënde bëhej fjalë?

16 PË. Po, z. Gjykatës. Unë në vitin 2001, më 8 maj, jam
17 arrestuar me akuzën për vrasjen e komandant Drinit. Kam
18 qëndruar në burg për dy vite. Pas 126 seancave gjyqësore, tre
19 paneleve gjyqësore që i kishte thirrur Steiner, një pas një,
20 sepse asnjë nuk mund të vinte deri te një vendim, më 23 mars
21 të vitit 2003 jam liruar i pafajshëm. Edhe unë, më pas pastaj
22 janë liruar edhe ata të grupit me të cilin kam qenë i
23 arrestuar.

24 Por jam dënuar me dy vjet e gjysmë për armëmbajtje pa
25 leje, ato armë të cilat u gjetën në shtëpinë time kur unë jam

1 arrestuar. Domethënë, lënda për çfarë jam arrestuar, jam
2 shpall i pafajshëm, por më kanë dënuar me dy vite e gjysmë për
3 armëmbajtje pa leje.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin,
5 Dëshmitar, sepse po shikoj këtu aktgjykimin, edhe në fakt
6 sipas procesverbaleve ju jeni deklaruar i pafajshëm për një
7 pretendim për bashkëpunim për vrasjen e Drinit. Pra, e vërteta
8 është që ju e keni një dënim penal të marrë ndaj jush, apo jo,
9 Dëshmitar? Sepse jeni dënuar për mbajtje armësh, a është
10 kështu?

11 PË. Po, z. Gjykatës. Ashtu është.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe i bashkakuzuari tjetër
13 dhe ish-anëtari i UÇK-së Sali Veseli, me sa kuptoj unë, është
14 dënuar për vrasjen e Drinit. A është e drejtë kjo të thuhet,
15 Dëshmitar, është e saktë kjo?

16 PË. Në atë moment kur jam liruar unë, ai është dënuar me 15
17 vite, mirëpo që është pas një viti është liruar edhe ai i
18 pafajshëm.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më pas ai u rigjykua dhe u
20 dënua përsëri. A ka ndodhur kështu, është e saktë kjo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Nuk më kujtohet, z. Gjykatës. Mund të gabohem tani. E
23 mbaj mend që një herë është liruar pastaj nuk di më, nuk më
24 kujtohet.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit

1 tani të kalojmë në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykses

Faqe 96

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykses

Faqe 97

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykses

Faqe 98

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykses

Faqe 100

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykues

Faqe 102

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykses

Faqe 105

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë private)
Prokurori nga Trupi Gjykues

Faqe 106

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
20 bëjmë dhjetë minuta pushim.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 15.41

22 --- Seanca rifillon në orën 15.50

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të sillni
24 dëshmitarin në sallë.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Kërkova leje për pesë minuta

1 parashtrime para se të vijë dëshmitari që të mos ju ndërpres.

2 Dua të ngre një shqetësim që kemi të gjithë ne, si ekipet
3 e Mbrojtjes, por dhe mund të bëjmë parashtrime e tyre.

4 Sa i takon këtij dokumenti konkret ju e dini, Gjykatës,
5 që nga kundërpyetjet e mia që nuk ka asnjë çështje fare, që ky
6 është një mashtrim i madh. E njëjta gjë vlen për pyetjet që
7 burojnë nga dokumenti P500 që kanë lidhje me pyetjet e
8 Gjykatësit Barthe.

9 Pra, ne kemi shqetësimin që Trupi Gjykues po përpiqet të
10 fajësojë dëshmitarin për një çështje që nuk ka lidhje fare me
11 çështjen e Mbrojtjes. Kjo nuk është ngritur nga asnjë prej
12 palëve deri tani. E njëjta gjë vlen për Prokurorinë e cila po
13 mbështetet në besueshmërinë e këtij dëshmitar.

14 Ata po e përdorin këtë dëshmitar pikërisht për të
15 vërtetën që do të thotë. Nuk i takon Trupit Gjykues që të
16 sfidojë apo të kundërshtojë besueshmërinë e këtij dëshmitari.
17 Ne nuk e kemi trajtuar në këtë qasje, nuk ka qenë kjo qasje
18 jonë dhe nuk ka qenë qasja e Prokurorisë dhe nuk e ka
19 kompetencë Trupi Gjykues t'i bëjë pyetje të tilla dëshmitarit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, e ka, në
21 fakt, Trupi Gjykues se edhe ne do të vazhdojmë me pyetjet
22 tona.

23 Z. PACE: [Përkthim] Ka diçka për të thënë lidhur me këto.
24 Mendoj se Avokati duhet të kufizohet me parashtrimet e veta.
25 Nuk i takon Avokatit të flasë lidhur me qasjen e Prokurorisë

1 lidhur me këtë dëshmitar nëse është mbështetshmëria apo
2 besueshmëria e këtij dëshmitari. Të presim deri në fund dhe më
3 pas të flasim.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Është çështje parimi kjo dhe për të
5 ardhmen. Dëshmitarit iu bë pyetje për ekspertin kaligrafik --

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk e pyeta. Ai
7 vullnetarisht e dha përgjigjen.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Po unë e kam shqetësim këtë gjë dhe
9 dua ta them që ne tani jemi në një situatë kur keni përfshirë
10 aktekspertizën e një eksperti kaligrafik përmes këtij
11 dëshmitari.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk e përdorëm këtë
13 ekspertizën. Ishte thjesht një pyetje. I thamë, a të kujtohet
14 të jetë bërë kjo; a ju kujtohet si ka qenë përfundimi i
15 ekspertit kaligrafik që është në dokumentin përkatës. Pra,
16 shkrimi i dorës i deklaratës në fjalë rezultoi se në të
17 vërtetë ishte i Kimete Krasniqit. Ne nuk i kërkuam
18 aktekspertizë dëshmitarit.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Po unë pikërisht këtë po
20 kundërshtoj. Përmes këtij dëshmitari ju po përfshini në
21 dokumentet gjyqësore aktekspertizën e një akt-eksperti. Nuk
22 është problemi i vetëm me këtë dokument. Ky është problem dhe
23 për të ardhmen me dokumente të tjera. Është çështje parimi.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
25 trajtojmë kur të vijë rasti konkret.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 110

1 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 Gjykatësi Mettraux ka ende pyetje për ju.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të
6 vendosë në ekran materialin SPOE00035842. Ju lutem, shkojmë në
7 faqen SPOE00035880. A mund ta ndajmë ekranin, ju lutem, që të
8 vendosim dhe faqen tjetër përbri që ka numër SPOE00035881.

9 Kjo, zotëri, është deklaratë e Kimete Krasniqit e cila
10 është gjetur, të paktën sipas të dhënave, është gjetur në
11 banesën tuaj. Po ju jap një çast ta lexoni dhe pasi ta keni
12 lexuar dhe unë do t'ju lexoj anglishten për personat që nuk
13 flasin shqip.

14 "U bëra anëtare në radhët e UÇK-së më datën 10 prill 1998
15 në zonën operative të Drenicës me epror Fehmi Lladrovcin. Si
16 kusht për të hyrë ushtar ka qenë kryerja e një aksioni të një
17 shqipfolësi i cili punonte në sigurimin e shtetit serb.

18 "Këtë kusht e pranova me dëshirë mbasi isha në gjendje të
19 bëja gjithçka, vetëm të isha ushtar. Në dijeni për këtë
20 aksion kanë qenë Musë Jashari, Fehmi Lladrovci, Jahir Demaku -
21 ju kërkojmë ndjesë për - Jahir Demaku etj., - më falni. Ndërsa
22 unë në datën 15 prill '98 kam marrë armën dhe më 19 prill '98
23 në orën 17.35 ka përfunduar aksioni. Në aksion kanë marrë
24 pjesë edhe Skënder Halili, i cili ishte si përgjegjës dhe
25 Fadil Demaku. Por edhe pse aksioni ishte përgatitur mirë dhe

1 erdhi në kohën e caktuar personin me emrin Hamëz Shtutica, pas
2 shumë rafallash të automatikëve dhe marrjes së 7 plagëve, ai
3 shpëtoi. Ndërsa në muajt maj dëgjova nga disa shokë se ai
4 ishte në Maqedoni dhe e kishte kidnapuar UÇK-ja, por tash
5 prapë më kanë njoftuar se është i lirë në qytetin e Drenasit
6 dhe se jemi të rrezikuar nga ai për arsye se ai e di se e kam
7 përgatitur unë aksionin kundër tij, dhe për këtë arsye nuk
8 mund të veproj në zonën operative të Drenicës.”

9 Kalojmë tani në seancë private, ju lutem.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 Faleminderit.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

15 Kam dhe një dokument tjetër që dua t'ju tregoj dhe më
16 pas do t'ju kërkoj të komentoni lidhur me këtë dokument nëse
17 keni mundësi. Është dokumenti që mban numrin SITF00245381 deri
18 në SITF00245385-ET. Faleminderit. Për ta ndihmuar dëshmitarin,
19 ju lutem, më nxirrni dhe versionin në shqip që është me numër
20 SITF00245112, ju lutem. Vendosini dokumentet përbri njëri-
21 tjetrit.

22 Ndërkohë që presim dokumentin, Dëshmitar, po ju tregoj
23 kontekstin. Kjo është diçka që e keni diskutuar më duket se
24 dje ishte. Është një fragment i një libri që ka shkruar Bedri
25 Islami edhe ka lidhje me Ali Ahmetin edhe titulli është "I

1 vërteti Ali Ahmeti." A e njihni këtë libër?

2 PË. Jo, zotëri, nuk e kam lexuar deri tani.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë më poshtë te
4 shqipja.

5 Dëshmitar, ju lutem, lexoni nga paragrafi që fillon
6 "frika për goditjen ..." E gjetët? "Frika për goditjen ..."
7 Lexoje dhe më thoni kur të keni përfunduar.

8 Tek anglishtja fillon me fjalët "Dyshimi i parë."
9 Megjithatë, po ju jap kohë fillimisht ta lexoni dhe t'ju jap
10 dhe kontekst.

11 Autori këtu flet për frikën dhe shqetësimet e UÇK-së për
12 të infiltuarit, për infiltrimet dhe paragrafi i parë që dua
13 unë të lexoni ju është:

14 "Dyshimi i parë erdhi andej dhe nga nuk pritej. Ai erdhi
15 nga qelitë e burgut. Në mbledhjen e përbashkët që kanë bërë
16 përfaqësuesit e LPK-së brenda vendit dhe të kryesisë së
17 Këshillit të Kosovës dhe kryesia - kalojmë, të lutem, faqen -
18 të Këshillit - kryesisë të këshillit të atdhetarëve - më falni
19 - më 23 dhjetor deri më 25 dhjetor 1993, ku është thënë
20 shprehimisht se Xhavit Haziri që ishte në burg, kishte dërguar
21 fjalë përmes anëtarëve të familjes së tij se 'Shtëpia që kemi
22 filluar të ndërtojmë duhet ta lemë, duhet ta lemë fare; tullat
23 janë të dobëta dhe do të rrëzohet përnjëherë. Kështu që të
24 lemë, lejojmë kolegët të kthehen dhe të studiojnë atje, pra,
25 shtëpinë që kemi filluar ta ndërtojmë ta lemë krejt se tullat

1 i ka të dobëta dhe u rrënohet menjëherë. Prandaj shokët le të
2 kthehen e të studiojnë aty ku kanë qenë.”

3 “Ky është lajmërimi i parë dhe ai që ka treguar pas
4 Xhavit Hazirit në periudhën e shkurtër të lirimit nga burgu
5 dhe zhdukjes së tij pas kidnapimit serb në pranverën e vitit
6 '99. Faktet dhe pyetjet që i kishin bërë hetuesit serbë dhe
7 shqiptaro-serbë dëshmonin se ata kishin filluar të binin në
8 gjurmët e strukturave të para të armatosura.”

9 Tani pyetja ime e parë është kjo, pyetja e parë është: A
10 e njihni kush është Xhavit Haziri?

11 PË. Unë vetëm kam lexuar për të. Nuk e kam njohur kurrë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na e konfirmoni
13 se ka qenë i ndaluar katër herë nga autoritetet jugosllave,
14 përfshirë në vitin 1993?

15 PË. Po, mendoj që kam lexuar për të.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më tej libri thotë:

17 “Në takimin e mësipërm sipas procesverbalit të mbajtur
18 merrnin pjesë: Besimi (Azem Syla), Daja (Fazli Veliu),
19 Bashkimi (Adnan Asllani), Qamili (Halil Selimi), Selimi
20 (Hashim Thaçi), Abazi (Ali Ahmeti), Muhameti (Emrush Xhemajli)
21 dhe Zeka (Xhavit Haliti).”

22 Pyetja ime lidhur me këtë është: A keni pasur dijeni ju
23 që është mbajtur ky takim i 23 dhjetorit deri më 25 dhjetor
24 1993?

25 PË. Jo, zotëri. Ne anëtarët e thjeshtë nuk kemi pas dijeni

1 për këto takime të njerëzve eminent të udhëheqësve tanë.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flas dhe për anëtarët
3 pas një çasti. Tani do kaloj te paragrafi, thotë që: "Nuk kam
4 renditur emrat ... Nuk i solla rastësisht emrat." Tani pas
5 këtij paragrafi unë do të lexoj këtë:

6 "Në fakt, në këtë periudhë pas arrestimeve që kishin
7 ndodhur në Kosovë më 2 gusht 1993 ku në të njëjtën orë ishin
8 arrestuar anëtarët e sapozgjedhur të Këshillit të Përgjithshëm
9 të LPK-së: Bajrush Xhemajli dhe Xhavit Haziri, Ahmet Haxhiu,
10 Nehat Selimi në Prishtinë; Hysen Gega dhe Ilaz Kadolli në
11 Suharekë; Behajdin Hallaqi në Prizren; Ramadan Pllana në
12 Vushtrri: Janë kërkuar që të arrestohen Ramadan Avdiu, Kadri
13 Veseli, Ramiz Lladrovci, Ibish Neziri. Kurse kaluan në
14 klandestinët: Hashim Thaçi, Adnan Asllani, Halil Selimi dhe
15 Azem Syla, njerëzit që u takuan në Mbledhjen e Përbashkët;
16 ishin drejtuesit kryesorë të organizatës dhe të ngarkuar për
17 ngritjen e strukturave të armatosura."

18 Pyetja ime e parë është: A ju kujtohet që të kenë ndodhur
19 këto arrestime në 1993 për udhëheqësit e spikatur apo
20 udhëheqësit kryesorë të LPK/UÇK-së?

21 PË. Po, z. Gjykatës, më kujtohet. Unë isha në Zvicër, por më
22 kujtohen arrestimet. Ka pas përafërsisht 100 deri në 104
23 persona që janë arrestuar atë vit.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet gjithashtu
25 që ka dhe disa të tjerë, pra, disa persona të tjerë për të

1 cilët është ngritur aktakuzë apo të cilët janë kërkuar nga
2 sistemi serb, përfshirë këtu Kadri Veselin dhe Hashim Thaçin.
3 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

4 PË. Vazhdimisht kemi pas të ngritur aktakuza nga gjykatat
5 serbe. Tash nuk më kujtohet diçka specifikisht, por ka pasur
6 shumë, shumë ndjekje, shumë arrestime, shumë kërkesa për
7 depërtime. Por diçka më konkretisht nuk mund të kujtohem sot.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju kujtohet që disa prej
9 këtyre individëve, domethënë, personat që kanë qenë aktiv dhe
10 janë përpjekur që të krijonin UÇK, kanë vepruar, kanë vepruar
11 në fshehje, domethënë, kanë vepruar në mënyrë të tillë që të
12 mund mos kapeshin ose të mos diktoheshin nga forcat serbe ose
13 autoritetet serbe?

14 PË. Normalisht të gjithë anëtarët e lëvizjes sonë si LPK apo
15 të lëvizjeve të tjera siç ishin LKÇK e të tjerat, të gjithë
16 kanë punuar në mënyrë të fshehtë sa më të fshehtë që të mos
17 bien në sy edhe të mos, të mos arrestohen.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Paragrafi tjetër thotë si
19 më poshtë:

20 "Interesant është fakti se në disa nga organizmat bazë të
21 Lëvizjes Popullore të Kosovës, Këshillat Popullore, siç
22 quheshin atëherë, kishte një ngritje të veprimtarive të tyre
23 për dy arsye themelore: Kërkohej analizimi i shkaqeve që
24 kishin çuar deri tek arrestimet dhe më e rëndësishmja ---

25 PË. Z. Gjykatës.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] -- kërkohet një mënyrë e
2 re pune."

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

4 PË. Kërkoj falje.

5 Pas fjalës Lëvizja Popullore e Kosovës, Këshillat
6 Popullorë, siç quheshin atëherë, kishte një ngrirje. Ngrirja
7 është tërheqje e punës e jo ngritje të punës. Përkthimi ishte
8 "ngritje", kurse këtu shkuan "ngrirje." Ngrirja është
9 moratorium.

10 Më fal përkthyes se të ndërhyra.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Këtë pyetje doja t'ju bëja
12 në fakt, zotëri. Doja që t'ju kërkohet që të shpjegonit me
13 fjalët tuaja, nëse është e mundur. Pra, se si arrestime të
14 tilla dhe kërkesa ose përpjekje të tilla nga sistemi serb ose
15 për të ndaluar, ose përndryshe për t'u marrë me anëtarët e
16 LPK-së kanë pasur ndikim mbi këshillat popullorë, ose në
17 rastin në fjalë, për shembull, mund të flisni për këshillin
18 popullor në Zvicër ose më në përgjithësi në qoftë se është e
19 mundur? Pikërisht për këtë doja t'ju bëja pyetje.

20 PË. Mua, z. Gjykatës, më kujtohet kjo kohë, kjo periudhë kur
21 u arrestuan shumë njerëz tanë eminent që kishin vepruar për të
22 mirën e Kosovës, ishte një goditje tepër e madhe. Ju thashë
23 edhe para se janë arrestuar mbi 100 persona dhe normalisht që
24 ka qenë brengë e secilit anëtar edhe, edhe kryesisë edhe
25 këshillit të përgjithshëm se si erdhi kjo. Normalisht shihej

1 që diçka, diçka dikun çalonte, diçka, diçka dikun ishte bërë
2 një gabim se nuk ishte e mundur aq shumë njerëz të binin në
3 një kohë kaq të shkurtër.

4 Prandaj është edhe kjo këshillat popullorë -- kanë
5 kërkuar një ngrirje, një ndalim që ta analizohet pse po ndodh
6 gjithë ky arrestim, pse po ndodh gjithë kjo dekonspirim i
7 radhëve tona.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe cili ka qenë rezultati
9 i analizës që keni bërë juve në këshillat popullorë, në qoftë
10 se ka pas ndonjë përfundim?

11 PË. Ne në këshillat popullorë nuk kemi mundur ta bëjmë këtë
12 analizë. Këtë analizë kanë mundur ta bëjnë vetëm ata që janë
13 direkt që ishin direkt të involvuar në lëvizjet edhe në
14 koordinimet brenda vendit në Kosovë. Unë nuk kam qenë në atë
15 nivel, z. Gjykatës, që të jem në atë rreth të ngushtë të asaj
16 kohës.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.
18 Nuk kam pyetje të tjera për ju.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
20 Gaynor.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
22 Smith.

23 Mirëdita, Dëshmitar. Kam edhe disa pyetje të tjera për
24 ju, kryesisht janë pyetje që kanë të bëjnë me sqarime të disa
25 paqartësive në dëshminë tuaj.

1 Së pari, besoj që e keni konfirmuar që Nexhmi Krasniqi ka
2 qenë komandanti i policisë ushtarake në nivel zone në zonën
3 operative të Pashtrikut. A e keni konsideruar ju atë si anëtar
4 të komandës së zonës, Dëshmitar?

5 PË. Nexhmi Krasniqi, komandant i policisë ushtarake, është
6 konsideruar si pjesë e zonës, është konsideruar si pjesë e
7 zonës.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Të komandës së zonës,
9 kështu?

10 PË. Aty nuk -- besoj që po. Po. Po.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më herët ju thatë që në
12 qoftë se ju i kërkonit policisë ushtarake të bënte diçka,
13 mënyra se si e kam kuptuar është që procedura ishte e tillë që
14 duhej t'i bënit një kërkesë komandantit të zonës e pastaj
15 komandanti i zonës lëshonte një urdhër për policinë ushtarake
16 ose për komandantin e policisë ushtarake që në këtë rast ishte
17 Nexhmi Krasniqi; a ju kujtohet ta keni thënë këtë më herët,
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, z. Gjykatës.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetje ime për ju është kjo:
21 Nga e dinit ju që kjo ishte struktura që duhet që të ndiqnit?
22 A keni pasur ndonjë dokument me shkrim kur parashikohej kjo
23 procedurë?

24 PË. Z. Gjykatës, ne si zonë nuk kemi pas ndonjë rregullore,
25 nëse mendoni për rregullore, por në mars të '99-s unë, Sadik

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 120

1 Halitjaha edhe me aprovimin e komandant Tahir Sinanit e kemi
2 bërë një rregullore provizore se si të veprojmë të gjithë G-të
3 e zonës tonë e kush me kënd të koordinohet, si të koordinohemi
4 të gjithë së bashku. E kemi pas një rregullore në dokumentet e
5 mia, përfshirë përafërsisht 12 faqe A4. Por rregullore të kemi
6 -- nuk kishim nga Shtabi i Përgjithshëm një rregullore të
7 përgjithshme për të gjitha. E kam -- e kemi bërë vetë. E kemi
8 bërë një rregullore vetë. Na ka vulosur komandant Tahir Sinani
9 me vulën e vogël të Zonës Operative të Pashtrikut. E ka
10 vulosur edhe Bislum Zyrapi në Shtab të Përgjithshëm me vulën e
11 madhe të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Brenda asaj
12 rregullore jemi mundur që t'i përshtatemi punës tonë, sepse
13 nuk kishim diçka më të madhe.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e keni kuptuar ju kështu
15 që komandanti i zonës kur lëshonte urdhra për komandantin e
16 policisë ushtarake, pra, për Nexhmi Kastratin - pra, më falni
17 - Nexhmi Krasniqin, më pas siguronte që njësitet e policisë
18 ushtarake në nivel brigade dhe në nivel batalioni i ndiqnin
19 këto urdhra? A e keni kuptuar që ka funksionuar kështu,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po, z. Gjykatës. Varësisht nga lloji i intervenimit që
22 duhej të jepte, sepse kishte ndonjëherë kishte raste kur i
23 jepte urdhër policisë ushtarake të kryente një detyrë, por e
24 mbështeste edhe me një kompani ushtarake që ta ndihmojë
25 policinë ushtarake. Domethënë, krejt varësisht nga situata të

1 ndryshme siç kanë lindur, por kryesisht ishte Tahir Sinani ai
2 që ka mundur të jepë urdhra të gjithëve neve që ishim aty.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju e keni thënë - dhe për
4 procesverbal këtë e keni thënë në faqen 22714 - dhe këtu
5 citoj:

6 "Çdo gjë, serioze apo jo, ishte detyrë e jona që t'i
7 raportnim ato gjatë takimeve që kishim me komandantin, me
8 zëvendëskomandantin dhe me sektorët e tjerë me të gjashtë G-të
9 e sektorët G të tjerë ... ne kemi pasur mbledhje të përditshme
10 me komandantin dhe mbledhje të përjavshme me sektorin."

11 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

12 PË. Po, z. Gjykatës.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ndërkohë që dua t'ju pyes që
14 komandanti i policisë ushtarake, a ka qenë i pranishëm në këto
15 mbledhje të përditshme me komandantin dhe zëvendëskomandantin?

16 PË. Jo të gjitha takimet ka marrë pjesë ai. Ka mund, ka
17 mundur të mos jetë prezent, mirëpo shumicën e takimeve ka pas,
18 ka pas obligim të jetë edhe ai.

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Gjatë periudhës kur keni
20 shërbyer si komandant i ZKZ-së në zonën operative të
21 Pashtrikut, këto mbledhje ose takime të përditshme realisht
22 kanë ndodhur çdo ditë?

23 PË. Çdo ditë kur kishim mundësi, z. Gjykatës, kur ishim në
24 gjendje që të takoheshim edhe të flisnim, sepse kishte shumë
25 ditë kur kishte ofensiva, kishte luftime, nuk kishim kohë për

1 takime.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mbaheshin procesverbale në
3 këto takime?

4 PË. Unë mendoj se po. E mbante vetë shënim komandant Tahir
5 Sinani ose Komandant Drini. Mirëpo, ne të gjithë ata që ishim
6 këshilltarët e tij apo ndihmësit e tij, ne secili ia jipshim
7 ndonjë letër të shkruar që t'i ketë ai më vonë për të
8 analizuar vetë se çfarë situatë do të jetë. Prandaj unë të
9 gjitha ato që i keni parë deri tani që është vetëm një
10 përqindje e vogël, të gjitha i kam të shkruara secilin raport,
11 secilin propozim, secilin mendim timin ia kam dhënë me shkrim
12 që ai ta ketë për ta lexuar, e jo vetëm aty për aty për ta
13 dëgjuar.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Atëherë, tani ndërkohë që po
15 flasim për procesverbalet e takimeve ose mbledhjeve të
16 përditshme, këto procesverbale ose këto shënime, a i
17 përcilleshin Shtabit të Përgjithshëm?

18 PË. Ishte në dorën e komandantit të vendoste a do t'i
19 përcillte në Shtabin e Përgjithshëm apo jo. Nëse ai e shihte
20 të rëndësishme që të përcillej do ta përcillte; nëse ai nuk e
21 shihte të rëndësishme mund të mos ta përcillte.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Më herët sot në përgjigje të
23 pyetjeve të Gjykatësit Barthe, mendoj se ju thatë që ju e
24 kuptuat në një pikë që raportet që ju i kishit dhënë
25 komandantit të zonës, dhe ku shprehimisht kishin thënë që këto

1 duhej të ishin raporte që duhet që t'i përcilleshin Shtabit të
2 Përgjithshëm dhe ju e kuptuat në një pikë kohën, që në fakt
3 disa prej këtyre raporteve nuk i ishin përcjellë Shtabit të
4 Përgjithshëm; a është e saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Po, z. Gjykatës.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga e keni kuptuar ju këtë
7 gjë?

8 PË. Me mosintervenimin e Shtabit të Përgjithshëm, me
9 mosintervenimin e ndryshimeve -- për ndryshimin e atyne
10 gjërave që unë kam kërkuar sipas atyre raporteve se tash nuk
11 kam diçka specifikisht. Mirëpo, me mosrealizimin e atyne
12 kërkesave edhe mendimeve të mia, kam kuptuar se askush nuk po
13 merret, nuk po merret me ato probleme.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e dini se cila pjesë ose
15 në çfarë përqindje raportet e përgatitura prej jush, në fakt,
16 nuk i janë dërguar Shtabit të Përgjithshëm? Domethënë, sa prej
17 tyre janë dërguar në përqindje Shtabit të Përgjithshëm, pak a
18 shumë, dhe sa prej tyre nuk janë dërguar?

19 PË. Unë nuk mund të them këtë, se nuk kam guxu -- nuk kam
20 mundur as t'i kërkoj asnjë komandanti cilin e ke dërgu, cilin
21 s'e ke dërgu. Ka qenë në dorën e tij të vendosë të apo mos ta
22 lajmërojë Shtabin e Përgjithshëm.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shkurtimisht dua t'ju pyes
24 lidhur me mbledhjet e përjavshme me sektorët. Na ke thënë disa
25 herë gjatë dëshmisë që ju, pra, sektorët, keni pasur mbledhje

1 të përjavshme. A mund të na shpjegoni se kush ka qenë i
2 pranishëm në takimet ose mbledhjet e përjavshme të sektorëve?
3 PË. Nëse kanë qenë të gjithë shëndoshë e mirë, të gjithë kanë
4 marrë pjesë prej G1-shit që është -- G1-shi, G2-shi, nëse doni
5 t'ju flas me emra apo me numra? G1-shi, G2-shi, 3-shi, 4-shi,
6 5-shi deri te i fundit që ishte Sami Seda nga G. Mandej ishte
7 Nexhmi Krasniqi; mandej ishte shefi i shtabit, shefi i shtabit
8 ose Nexhmedin Kastrati ose ashtu. Domethënë, komandanti,
9 zëvendëskomandanti, këta ishin ajo pjesë që takoheshim për çdo
10 javë edhe secili i nxirrte në pah nevojat, kërkesat, obligimet
11 edhe çfarë kishin bërë apo çfarë duhej të bënin edhe çfarë
12 kishin nevojë për të bërë një punë të caktuar për [E
13 padëgjueshme].

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Prapë nuk e kuptoj
15 plotësisht. Nuk e kuptoj tërësisht dallimin ndërmjet
16 mbledhjeve të përditshme me komandantët dhe mbledhjet e
17 përjavshme në të gjithë sektorët, sepse në takimet e
18 përditshme të gjithë sektorët ishin të përfaqësuar edhe në
19 këto takime. A ka qenë kështu, Dëshmitar?

20 PË. Jo, z. Gjykatës. Takimet e përditshme kanë mund të jenë
21 edhe në hapësirë. Takimi i përditshëm ka mund të jetë edhe në
22 rrugë, të thuhet si je, nuk kam diçka të re ndonjë send, apo
23 ta pyesësh diçka komandantin. Kurse takimi javor, takimi javor
24 përfshinte punën e tërë javës, kërkesat për tërë javë,
25 kërkesat materiale apo çfarë kishin nevojë ato sektorët e

1 tjerë.

2 Domethënë, javorja ishte e obliguar si briefing; kurse
3 ditore mund të takohej, mund të mos takohej, mund të
4 diskutonte gojarisht. Ishte më e përditshme, më e vogël apo më
5 -- më platonike.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Sa për ta sqaruar, a
7 mbaheshin shënime ose a mbaheshin procesverbale edhe në
8 takimet e përditshme edhe në ato të përjavshme?

9 PË. Të përditshme, jo. Në të përjavshmet, po.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po procesverbalet e takimeve
11 të përjavshme, me aq sa dijeni keni ju, a i përcilleshin
12 Shtabit të Përgjithshëm?

13 PË. Unë mund të flas për vete. Ato që i kam shkruar unë
14 gjithmonë i kam shkruar edhe me i dërguar Shtabit të
15 Përgjithshëm. E a i kanë shkuar apo s'i kanë shkuar ky ishte
16 problem vetëm i komandantit. Nuk kam mundur ta pyes, pra.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kaloj në një temë
18 tjetër. Do kaloj te tema e radhës.

19 Ka të bëjë me postblloqet. Keni dhënë dëshmi që
20 shkruheshin, mbaheshin shënime emrat dhe këto emra i jepeshin
21 personave të cilët qëndronin në postblloqe, dhe këta ishin
22 emrat e personave që ishin bashkëpunëtor të dyshuar; a ju
23 kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

24 PË. Po, z. Gjykatës. Jo bashkëpunëtorë të dyshuar, por
25 punëtorë, punëtorë të sigurimit serb, punëtorë të aparaturës

1 serbe që na kishte okupuar. Për bashkëpunëtorë ka pas ndoshta
2 edhe ndonjë të tillë, por bashkëpunëtorë mund të quhet dikush
3 edhe mund të mos jetë dikush.

4 Por për punëtorët e sigurimit, për punëtorët e asaj
5 aparaturës me siguri që po. I kemi dorëzuar secilit postbllok
6 një bllok shënimesh që të jetë gjithmonë në postbllok, sepse
7 aty ndërroheshin çdo dy orë rojet. Mirëpo ai -- shënim, ai
8 bllok ka qëndruar gjithmonë në postbllok.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mendoj që nuk kemi më kohë
10 për sot. Do na duhet që të vazhdojmë nesër paradite me pyetjet
11 e tjera. Faleminderit për sot.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirë, më thanë që mund të
15 vazhdoj. Do vazhdoj më tej.

16 Hapat që merrni ju pasi një person që ishte në listë,
17 çfarë bënit ose çfarë udhëzimesh jepnit ju për personat që
18 punonin në ato postblloqe për të bërë me personat emrat e
19 cilëve ishin në listë? Çfarë ndodhte me këta persona?
20 PË. Z. Gjykatës, edhe sot e kam deklaruar këtu edhe me të
21 tjerët, ata persona ishin për mos t'u lejuar që të hynë në
22 territoret tona ku ne jetonim, vepronim edhe që ishim të
23 instaluar ne. Ata emra ishin vetëm për ta ruajtur veten edhe
24 popullatën ku ne jetonim. E jo për të vepruar apo për të
25 hetuar jashtë, jashtë postblloqeve tona. Nuk lejoheshin të

1 hynin në zonat ku ne vepronim.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shqetësimi që kam unë lidhur
3 me përgjigjen e dhënë është që sa i takon perspektivës së
4 sigurisë së operacioneve ose aksioneve të UÇK-së në gjithë
5 Kosovën, a nuk po ekspozonit ju UÇK-në ndaj një rreziku të
6 madh, duke lejuar bashkëpunëtorë të njohur ose agjentë të
7 njohur që të vazhdonin që të qarkullonin brenda Kosovës?

8 Domethënë, pyetja që kam për juve është kjo: Pse nuk keni
9 lëshuar udhëzime për t'i arrestuar këta persona në postblloqe?
10 PË. Zotëri, ne kurrë nuk e kemi pas -- nëpër postblloqe?
11 Nëpër postblloqe thatë?

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, po. Ajo çfarë po them
13 unë është që trupat tuaj në postblloqe kishin emra të
14 bashkëpunëtorëve të dyshuar. Pra, në qoftë se ata duhej që t'i
15 ndalonin këta persona thjesht mund t'i thoni "mos hyni në
16 zonën operative të Pashtrikut". Domethënë, këtë po thoni ju që
17 këtë udhëzim kishit dhënë për të, që thjesht mos i lejoni që
18 të hynin në zonën operative të Pashtrikut?

19 PË. Udhëzimi ishte i tillë që mos të lejoheshin të hynin në,
20 jo në zonën operative të Pashtrikut, sepse edhe Prizreni ishte
21 në zonën operative të Pashtrikut, edhe Dragashi, edhe
22 Rahoveci, mirëpo Prizreni ishte plot me serbë. Unë e kam ruajt
23 vetëm fshatrat rurale ku ne ishim të përqendruar. Territori i
24 zonës është shumë i madh që mund ta kontrollojmë apo mund të
25 veprojmë ne kundër kundrejt atyne pjesëtarë të UDB-së.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shumë shkurtimisht. Ju thatë
2 që kishe 5500 FARK-istë në Tiranë, në Shqipëri; a ju kujtohet
3 që ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

4 PË. Po, zotëri.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ashtu keni thënë se i
6 keni kritikuar "ata që mbetën në Zvicër dhe në Gjermani që
7 argëtoheshin në një kohë kur njerëzit po vriteshin në Kosovë."
8 Pak a shumë. Keni thënë diçka të tillë?

9 PË. Po, zotëri. Por shumica e tyre ishin në Tiranë.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po atëherë mbi ç' baza thoni
11 ju që ka pasur 5500 FARK-istë në Tiranë?

12 PË. Po, zotëri. Në vitin 2015, Rrustem Berisha ka sjellë
13 listën prej 5500 pjesëtarëve të FARK-ut që të pranohen si
14 veteranë luftëtarë nga ana e Komisionit për Verifikimin e
15 Veteranëve.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po a besoni vërtet ju se ka
17 pasur 5500 anëtarë të FARK-ut që rrinin në Tiranë, ndërkohë që
18 UÇK-ja kryente operacione në Kosovë?

19 PË. Unë nuk mund t'u them atyre "Mos gënjeni." Ata vetë kanë
20 thënë "Kemi qenë kaq FARK-istë". Kurse ata që ishin brenda, që
21 kanë hyrë brenda, ata kanë qenë pjesë e UÇK-së. Kurrë nuk kanë
22 pas ndonjë emblemë tjetër. Po flasim vetëm për atë pjesën
23 jashtë. Ajo pjesa jashtë ka qenë nëse brenda kanë hy një herë
24 150, një herë 20-30 vetë, kanë qenë krejt afërsisht 200. Por
25 ata 5200-300 të tjerë që ai i solli që ne t'iu a pranojmë

1 statusin e veteranit ata ishin diku jashtë. Nuk është fjala
2 ime. Është dokumenti i tyre. Unë po flas me dokumentet e FARK-
3 ut, me dokumentet e Ministrisë së atëhershme të Mbrojtjes.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.
5 Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 Prokurori, ka pyetje shtesë bazuar në pyetjet e
8 Gjykatësve?

9 Z. PACE: [Përkthim] Unë kam, por nuk besoj që është
10 momenti për të filluar tani. Më pak se dhjetë minuta pyetje do
11 të kisha.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ma merr
13 mendja që ekipet e Mbrojtjes kanë pyetje.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po, po, kam pyetje, por do më duhet
15 të shqyrtoj një herë dokumentet.

16 Z. KOÇI: Gjykatës të nderuar, unë mendova se sot do të
17 përfundon, e kam një sqarim edhe e ngrita dorën për Gjyqtarin
18 në krahun e djathtë tuajin. Nuk po du me rreziku me ia shqiptu
19 gabimisht emrin.

20 Sa i përket dënimit për armëmbajtje pa leje, sipas nenit
21 96 të Kodit Penal të Kosovës, klienti im konsiderohet që nuk
22 është i dënuar, për shkak se është një institut juridik i cili
23 quhet rehabilitim ligjor. Pra, ky e ka të drejtën edhe më
24 thënë që nuk është i dënuar edhe pse, me sa mbaj mend,
25 Prokurorit i ka tregu për armëmbajtjen pa leje që është dënu

1 edhe është interesant që është dënu për aq kohë sa ka qenë në
2 paraburgim. Pas asaj ka ndodh edhe amnistitë për armëmbajtje
3 pa leje dhe ky ka pas ato trofe të luftës.

4 Veç desha me tregu si sqarim që kjo situatë i nënshtrohet
5 rehabilitimit ligjor. Meqë se po vazhdojmë nesër, unë e kam
6 një kërkesë që duhet ta bëj nesër në përfundim. Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Dëshmitar, ne shpresuam që do kishim mbaruar sot.

9 Fatkeqësisht kjo nuk ndodhi. Do duhet të ktheheni nesër, por
10 nesër do sigurohemi që të ktheheni në shtëpinë tuaj.

11 Faleminderit dhe mos flisni me askënd për dëshminë tuaj deri
12 në momentin e përfundimit të dëshmisë.

13 Tani mund të largoheni nga salla.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Faleminderit, z. Koci.

17 Po, z. Ellis?

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Ka dy aspekte të shkurtra që dua të
19 trajtoj, nëse më lejoni.

20 E para lidhet me dëshmitarin e radhës 4820. Me lejen tuaj
21 do t'i filloj unë pyetjet i pari edhe unë do të kem nevojë
22 vetëm për 20, 25 minuta kohë.

23 Pika e dytë --

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Pika e dytë ka lidhje me pyetjet që

1 do t'i bëjmë ne këtij dëshmitari. Është një dokument që unë po
2 mendoj që ta përdor për këtë dëshmitar. Është një nga 15
3 materialet për të cilat na njoftuat ju. A është e nevojshme ta
4 ngarkojmë në listën tonë të materialeve si procedurë?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju, në fakt,
6 nuk keni fare listë materialesh për momentin, kështu që e mira
7 është që ta ngarkoni në listën tuaj të materialeve për këtë
8 dëshmitar.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
11 Shihemi nesër në orën 09.00.

12 --- Seanca mbyllet në orën 16.39

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25